

## Politika nuk duhet të kthehet në institucion që pengon qytetarin...



Lexoni në faqen 3

## Videokaseteta që acaroi politikën

Opinionistët parashikuan saktë se edhe ky vit i ri do të sillte përplasje të reja në politikë, por në ndryshim nga ai 2010-të, këto do të ishin më të ashpra.

Lexoni në faqen 2

## Lasgushi dhe Tirona



Lexoni në faqet 8-9

### Horizonte

## Kufiri lindor dhe elitat

Lëvizja e kufijve lindorë gjatë shekullit të kaluar ndikoi në mënyrë vendimtare në “qarkullimin” e elitave në këtë pjesë të Evropës.

Lexoni në faqen 6

## Miqve të mi më të mirë



Lexoni në faqen 15

## Është koha për KASH

SOCIETE GENERALE ALBANIA

Së bashku për të ardhmen



www.societegenerale.al

Kredi Ardhme Shtëpi në Euro

**6.9%\***

\*Pas vitit të parë norma e interesit është Libor Euro 12M + 4.5% (për shumirë 0.9%) në vit

## “ Ditë Dimri” Pogradec – 2011



Lexoni në faqen 9

Editorial

# Videokasete që acaroi politikën

*Nga Dhimitër Gegprifti*

Opinionistët parashikuan saktë se edhe ky vit i ri do të sillte përplasje të reja në politikë, por në ndryshim nga ai 2010-të, këto do të ishin më të ashpra. Dhe këtë po e vërtetojnë më së miri “mohimet”, “pohimet” akuzat e ndërsjellta e të ashpra në distancë të përfshira në këtë vorbull të ri të politikës dhe të politikanëve shqiptarë. Shkaku: transmetimi i një videokasete në emisionin “Fiks-Fare”. Kjo përplasje e re, si një vazhdim i atyre të një viti e gjysmë më parë me të njëjtën përmbajtje, kjo për mazhorancë-opozitë, por tani midis krerëve të një partie LSI Prifti-Meta, e regjistruar tani, por e filluar muaj më parë.

Por një e veçantë e kësaj përplasje është se LSI është aleate në qeverisje: zëvendëskryeministri Meta dhe ministri i Ekonomisë, Energjitikës dhe tregëtisë Prifti “afera” për “favore” në dëm të ekonomisë kombëtare, “afera korruptive”.

Kjo përplasje vërtet e ashpër brenda llojit e shtriu rrezon e veprimtari deri te opozita, konkretisht lideri i saj Edi Rama. Ai akuzohet si: “autor”, “manipulator”, “çimkë”, “kryeçimkë”. Me këto “kërkon” të marrë pushtetin, por jo vetëm



kështu, por edhe me “dhunë”. Pothuajse çdo ditë zoti Meta bën akuza të reja, si: “frikacaku më i madh”, se ai e njeh më mirë se çdokush, si “bashkëpunëtor me krimin e organizuar”. Dhe se 9 maji do ta largojë nga Bashkia e Tiranës dhe nga politika shqiptare si një fitore mbi “fashizmin dhe spiunët”!. Të habit fakti: zoti Prifti, veç kësaj video “kompromentuese”, nëse është e vërtetë, pasi po vihet shumë në diskutim, aq sa dhe Prokuroria Shqiptare është në mëdyshje, kërkoi ekspertë nëpërmjet Ambasadës Amerikane, e cila po e shqyrton.

Zoti Prifti deklaroi se këtë veprim e ka bërë me vetëdije, ka edhe regjistrime e fakte të tjera të depozituara jashtë shteti, në Top-Story bëri akuza të reja, të cilat

vetëm ai i di dhe do të përgjigjet vetëm ai. Prifti deponimet i ka bërë edhe në Prokurori. Nga dita në ditë pritjet të thirret dhe zoti Meta, por tani i dorëhequr nga të dy postet, motivuar për të mos krijuar destabilitet dhe drejtësia të merret thjesht me qytetarin Ilir Meta. Dhe kjo është qytetari, është dinjitet moral, përgjegjësi morale për veten, për subjektin politik, për elektoratin. Kjo do të jetë më e besueshme dhe më e vlerësueshme, nëse akuzat nuk do të jenë reale dhe nuk do të përbëjnë çështje penale. Të njëjtat akuza të ashpra ka lëshuar zoti Berisha ndaj zotit Edvin Kristaq Rama e të tjerë, duke u kujtuar edhe baballarët!

Përsëri të habit fakti se përplasja nuk bëhet për vërtetësinë e

fakteve, për të cilat opozita është e “bindur”, por as edhe zoti Meta nuk hedh poshtë përmbajtjen e saj, jo të vërtetë, sipas Metës dhe mazhorancës, por e vlerëson këtë video si e “montuar”, “të manipuluar”, si “përgjim”. Për Prokurorinë videoja do të shërbejë si provë materiale. Komiteti European nëpërmjet zonjës Batler po kërkon në vazhdimsi që Drejtësia t’i shkoj deri në fund e të mos i krijohet asnjë pengesë.

Të njëjtën gjë ka deklaruar dhe zoti Berisha. Me sa duket “fati” i kësaj akuze është në dorën e ekspertve Amerikan. Është hera e dytë, kur drejtësia shqiptare vihet në provë për çështje të mëdha Gërdeci dhe Videokasete për qeveritarë të niveleve të larta, për të cilat është kërkuar ekspertiza Amerikane.

Opozita “kërcënon” Qeverinë se demonstratat do të vazhdojnë, sipas tyre, deri në Zgjedhje të Parakohshme si e vetmja zgjidhje politike. Së fundi, opinionin në tërësi presin Drejtësinë ta thotë fjalën e saj, për ta bindur dhe opinionin ndërkombëtar se Drejtësia Shqiptare nuk është ajo për të cilën ka shumë mëdyshje edhe për këtë çështje kaq akute për këtë videokasetë, që acaroi politikën shqiptare. Le të presim!

Kronikë

## Protestë e Këshillit Sindikal Pogradec



Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, duke parë gjendjen ekonomike tepër të rënduar dhe të papërballueshme nga shtresat e ndryshme të popullsisë për arsye të çmimeve shumë të larta, papunësisë në rritje dhe mungesës së dialogut social për zgjidhjen e kërkesave

ekonomike, vendosi të shpallë Protesta deri në largimin e Qeverisë. Edhe Këshilli Sindikal i Pogradecit, i pari në shkallë vendi, sipas folësve, organizoi protestë më datën 14.01.2011.

Në këtë protestë ishin thirrur gjithë sindikalistët e rrethit: pensionistë, ish-punonjës të industrisë minerare, arsimtarë e punonjës shëndetësie dhe të administratës publike, punonjës të ndërtimit, të drurit, infrastruktura publike, punonjës të sektorit të bujqësisë dhe të pyjeve, tregtisë, transporti dhe të papunët.

Pjesëmarrsit protestonin për mosmiratimin e Ligjit për moshën e tretë, statusin e minatorit dhe diferencimin në paga e pensione, për heqjen e pagës së 13-të dhe largimet pa kriter, për pagat e ulta dhe kushtet e papërshtatshme të punës, mos aplikimin e politikave nxitse dhe prodhimit vendas, taksat pa kriter, biznese të palicësuara, niveli i ulët i përkrahjes sociale, vendet e pakta të punës. Në këtë protestë folën zotrinjt: Nazif Dajlani dhe u mbyll me fjalën e Presidentit të Konfederatave Shqiptare zoti Kol Nikolla.

*Nga vizita e Presidentit të Republikës në qytetin e Pogradecit*

# Presidenti: Politika nuk duhet të kthehet në institucion, që pengon qytetarin

Presidenti i Republikës zoti Bamir Topi vizitoi qytetin e Pogradecit në këto ditë të para të vitit të ri 2011.

Axhenda e kësaj vizite ishte e thjeshtë. Rreth orës 11.20, të datës 13.01.2011, zoti Topi së bashku me eskortën, që e shoqëronte, u prit nga kryetari i Bashkisë, zoti Artan Shkëmbi, kryetari i Këshillit Bashkiak, zoti Gjergji Ilo, këshilltarë, punonjës të bashkisë dhe qytetarë të ndryshëm. Ishin të pranishëm gazetarë të mediave qendrore dhe ato lokale.

Kjo vizitë filloi me takimin kokë më kokë me kryetarin e Bashkisë, zotin Shkëmbi.

Takimi me këshilltarët me praninë e mediave. Në këtë takim zoti Shkëmbi ndër të tjera u shpreh:

I nderuar zoti President! Jam shumë i nderuar që në këtë takim të prezantoj punën e institucionit, që unë përfaqësoj. Pogradeci është një qytet me tradita të vjetra e të reja. Një qytet që vazhdimisht shkon drejt rritjes. Nga rreth 20.000 banorë në vitet "90" është dyfishuar dhe së bashku me të janë shtuar edhe probleme të kësaj rritjeje. Investimet tona në fushën e turizmit si aktivitet prioritar, në infrastrukturë, por edhe në traditat e vjetra e të reja. Qytetarët pogradecarë prodhojnë mobilje e prodhime të tjera, verën e rakinë. Pogradeci tani ka ujë 24 orë, impiantin e pastrimit të ujrave të zeza. Po vazhdohet me kanalizimet e ujrave të tjera. E gjitha kjo pasqyrohet edhe në harmoninë e qeverisjes së këtij qyteti. Pogradeci është një qytet i kategorisë së parë. Por duam të themi se një pjesë e madhe e disa institucioneve janë përqëndruar në Korçë dhe qytetarëve tanë për një dokument të thjeshtë u duhen ditë dhe shpenzime për ta siguruar atë. Pogradeci ka tregues të tillë, që



këto institucione të jenë këtu. Specifikat, resurset e këtij qyteti kërkojnë më shumë mbështetje. Ju kemi pritur prej kohësh! Zoti Shkëmbi i dhuroi Emblemën e Qytetit.

Ju faleminderit! Njëri nga këshilltarët pohoi bashkëpunimin e Këshillit Bashkiak në të mirë të qytetit dhe qytetarit, duke e argumentuar me miratimin e Buxheteve të çdo viti dhe të vitit 2011. Për ne "Partia jonë është Pogradeci!"

Në fjalën e tij Presidenti i Republikës transmetoi përshëndetjet për këshilltarët dhe gjithë qytetarëve të këtij rrethi. Ndër të tjera nënvizoi se kjo vizitë bën pjesë në ritualin e Institucionit të Presidentit. Edhe unë ndaj me ju të njëjtin mendim për bashkëpunimin e mirë, që ka kjo bashki dhe qyteti juaj. Në këtë mjedis ndihem mirë. Në çdo vend bëhen zgjedhje, politika duhet të prodhojë debat alternativ. Politika nuk duhet të kthehet në institucion, që pengon qytetarët. Jemi në një kohë, kur vendi po futet në Zgjedhjet Vendore, politika duhet të promovojë bashkëpunim, reflektimi, referimi në të mirë të qytetarit. Qytetarë të një qyteti me tradita. Fati buzë këtij liqeni unikal,

fati e ka dhënë të jetë qytet i traditave me vlera, fat i një qyteti me vlera turistike. Vitet e fundit është krijuar një klimë e mirë me fqinjët: Greqi, Maqedoni për shkëmbim përvoje. Një ambient i qetë, një politikë e qetë sjell edhe investitorë dhe turistë. Perspektiva e kësaj zone, kërkon nevojën e vlerësimit në kompleks. Bashkëpunimi duhet të dalë përtej Këshillit Bashkiak duke përfshirë gjithë komunat e këtij rrethi. Ka një rritje të sensibilitetit të qytetarit. Mungesa e bashkëpunimit midis forcave politike, kthehet në pengesë edhe për zgjedhjet e Përgjithshme. Jo kudo situata është si në Pogradec.

Unaza e Madhe e Tiranës nga viti 1989 është me projekt dhe me Buxhet, por nuk ka vullnet nga politika. Unë mendoj se politika duhet të reflektojë në të gjitha ambientet, ku abuzohet. Po të ekzistojë ky model si në Pogradec edhe zgjedhjet, që vijnë do të jenë të qeta. Ju inkurajoj dhe ju vlerësoj të vazhdoni kështu!

Një fotografi e përbashkët me Presidentin dhe Këshilltarët. Në vazhdim të vizitës Presidenti Topi vizitoi Qendrën Kulturorë "Lasgush Poradeci", Bibliotekën "Mitrush Kuteli" dhe mori pjesë

!!

*Jemi në një kohë, kur vendi po futet në Zgjedhjet Vendore, politika duhet të promovojë bashkëpunim, reflektimi, referimi në të mirë të qytetarit.*

!!

në çeljen e Ekspozitës së Artit Figurativ me piktorët më të mirë pogradecarë. Ai u shpreh për miqësinë me familjen e Kutelit; Pandin. Poliksenin, të cilët në çdo datëlindje i kanë dhuruar librat e Mitrushit. Pogradeci ka me se mburret: Mitrushin, Lasgushin e të tjerë. Pata nderin e madh që Kutelin ta nderoj me titullin e lartë "Nderi i Kombit", i vonuar, por i merituar.

Në Ekspozitë mirëseardhjen ia uroi drejtuesi i Galerisë së Arteve, "Piktori i merituar" Anastas Kostandini, i cili i dhuroi një tablo. Pas fjalës përshëndetëse të Presidentit, gazetarët i drejtuan pyetje për dy çështje me ndjeshmëri të lartë: transmetimi i Vidiokasetës dhe gjyqi i Gërdecit, për të cilat dha vlerësimin e tij.

*Dhimitër Gegprifti*

Pushtet Vendor

# Miratohet buxheti 2011

- Projekt-Buxheti i këtij viti 432.822.000 lekë të ardhura dhe shpenzime

Miratimi i strukturës së Bashkisë, institucioneve, ndërmarrjeve në varësi të saj, miratimi i taksave dhe tarifave vendore, miratimi i Buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2011, ishte axhenda e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të qytetit të Pogradecit e datës 28 dhjetor 2010. Nga burimet e informacionit mësojmë se në këtë mbledhje morën pjesë 15 anëtarë nga 25 gjithsej.

Të tre këta Projekt-Vendime janë miratuar në mënyrë unanime pa asnjë votë kundër. Për vitin që sapo kemi filluar Bashkia Pogradec ka parashikuar të punojë me të njëjtën strukturë të vitit 2010, po ashtu edhe niveli i taksave dhe tarifave vendore do të jenë të njëjta me ato të vitit të kaluar. Viti 2011 në sistemin e taksave dhe tarifave shton një tarifë të re: tarifë për emetimin e valëve të telefonisë celulare 450.000 lekë në vit, tarifë për sistemin kabllor 250.000 lekë në vit, tarifë për shfrytëzimin e truallit publik për infrastrukturën



nëntokësore: për telefoninë fikse, për CEZ-in.

Ky Buxhet është i fundit të këtij mandati dhe se viti 2011 do të jetë edhe një vit elektorale, por Bashkia nënvizon se ky Projekt-Buxhet nuk do të jetë elektorale, nuk do të ketë fillime investimesh, siç ndodh rëndom në vite elektorale. Qyteti vazhdon të përballet me nevojat në rritje, por me mundësi financiare, që mbeten gjithnjë të pakta në raport me këto nevojat. Nga analiza e

treguesve financiarë duket se kemi një rritje të të ardhurave të brendshme të krahasuara me vitin 2010, nëse do të realizohet me sukses përdorimi i kasave fiskale, si dhe kompesimi i qeverisë për kostot e këtyre kasave. Një burim tjetër i rritjes të të ardhurave do të jetë nga procesi i Legalizimeve, po ashtu dhe nga një rritje e ndjeshme e tarifës së reklamës dhe tarifave të reja për rrjetet kabllorë ajrore dhe nëntokësore.

Buxheti i këtij viti i Bashkisë Pogradec, do të përballojë detyrimet e këtij institucioni, për pagesën e kredisë të marrë në vitin 2010, si dhe detyrimet, që mund të ketë kjo Bashki nga proceset gjyqësore, megjithëse është bërë ankimi në Gjykatën e Lartë për të cilën nuk është marrë përgjigje.

Shpenzimi për planin rregullues të qytetit, detyrimi për kontributin e qarkut janë detyrime, që do t'i përballojë ky buxhet. Menaxhimi i mirë i këtij Buxheti, sipas këtij institucioni do të bëjë të mundur të ofrojë 13 prioritete të parashikuara në këtë vit në të mirë të komunitetit në të gjitha aspektet e jetës.

Nuk ka mbetur pa u rivendosur si prioritet trajtimi i administratës dhe i Këshillit Bashkiak, i cili, pothuajse, nuk i ka munguar çdo viti gjatë këtyre mandateve me një vlerë rreth 2.500.000.

Nuk e dimë nëse do të ishte kaq i domosdoshëm ky prioritet, në këto kushte dhe specifika të këtij viti të ri Buxhetor, kur dihet se së pari është vit elektorale?!...

Opinion

## Minatorët pjesë e Dhjetorit "90" - të

Kanë kaluar gati 20 vjet Demokraci dhe tani Lëvizja e Lirë e shqiptarëve në Dhjetorin 2010 u bë një realitet i prekshëm dhe konkret. Kjo ishte ëndrra, dëshira dhe e minatorëve, që punuan në minierat e vendit tonë, anë e kënd Shqipërisë në të gjitha llojet e tyre. Këta minatorë, jo vetëm kaq, por ata u bënë pjesë e Lëvizjeve Demokratike të atyre viteve, që u



ngujuan në greva urie për rrëzimin e qeverisë "Nano" në vitin "91" nga të parët ata të minierës së Valiasit, të mbështetur edhe nga minatorët

e rrethëve të tjera si Korçë e Pogradec dhe të udhëhequr nga sindikalistë si Gëzim Kalaja, të cilët veç kërkesave ekonomike, kishin

bashkë me ta edhe minatorët, si qytetarë të Europës. Kjo solli që shqiptarët të mos qëndrojnë më në radhët sfiluese të ambasadave dhe

dhe ato me karakter politik me moton: e duam Shqipërinë si Europa! Sot minatorët janë krenarë për kontributin e dhënë për Demokracinë, për vlerësimin e tyre si "Pishtar i Demokracisë" dhe që janë pjesë e Dhjetorit "90".

Kemi ardhur në ditën e Lëvizjes së Lirë, kur çdo shqiptar,

konsullatave për një vizë. Tashmë nuk do të ketë më, që prindëri të mos takohet me fëmijët. Nëse ke nevojë për një vizitë mjekësore, mund të shkosh pa problem.

Këta minatorë sot kërkojnë më shumë kujdes e vëmendje nga Qeveria, pasi një pjesë nga ata vuajnë nga sëmundje profesionale, ata marrin një pension fillimisht prej 14.000 lekësh.

Janë, jo pak, por afro 4.000 minatorë kanë trajtim të veçantë nga viti 2000. Ky problem duhet parë sa më shpejt, pasi një pjesë syresh po ndahen nga jeta. Edhe minatorët si pjesë e lëvizjeve të mëdha meritojnë një vëmendje të veçantë për arsyet e mësipërme.

Lavdërim Miminllari

-takim i përmallshëm shokësh pas vitesh...-

# As ti, as unë nuk do të dorëzohemi !

Nga Tomi Mato

Kopi Gushua dhe Thoma Panua (Tami) janë poradecarë me taban. I pari nga fisi më i vjetër i Gushollarëve dhe tjetri nga fisi i Panollarëve. U lindën, u rritën dhe vazhdojnë të jetojnë si qytetarë të nderuar. U martuan dhe lindën fëmijë, që dhe ata kanë vazhduar traditën e prindërve të tyre.

Në natën e ndërrimit të viteve, me telefon, u dërgova urimet më të përzemërta, ata më falënderuan dhe më bënë një kërkesë të thjeshtë:

-Urimet për Vitin e Ri 2011 duam të na i bësh në familje!

Kërkesa e tyre ishte e drejtë dhe unë vendosa ta zbatoj. Vizitova më parë Kopin, si më i madhi në moshë. Isha i bindur se do të më priste me vitalitetin e shpirtit. E gjeta jo ashtu si dëshiroja unë, atë Kopi të shumë viteve më parë...

Sa më pa, në bebet e syve filloi t'i qarkullojë një lëng i kristaltë. I ngashëryer dhe ashtu me forcën e krahëve më pushtoi. Duke përcjellë bulzat e lotëve më tha: -Më fal që s'të ngrihem dot!

-S'ka gjë, i thashë. Qoftë ky vit, viti i shëndetit dhe gëzimeve familjare dhe parave! Qeshi dhe ma ktheu me humor: -Shëndet, shëndet në radhë të parë! Këmbë, këmbë të kisha, këto do të ishin lumturia ime. Tomi, sikur të kisha këmbë, do të ngjitesha, jo ne çuka, po në majë të Kalasë. Më ka marrë malli ta shoh edhe njëherë Pogradecin, vendlindjen time të dashur, liqenin



dhe mbase do të më zinte syri ndonjë Nosit, që e përjetësoi xhaxhai, Lasgushi. Nuk do të mbaroja me kaq: do të zbrisja e të takoja të gjithë shokët. Në mënyrë të veçantë atë Tamin, kushëririn, që lëngon si unë... Por kujtimet ia ndërpreu padashur bashëshortja e përkushtuar, zonja e shtëpisë Vali me gotat e rakisë...

-Kopi gëzuar! Ngriti dorën. U ndala. -Vali, ngremë një çikë! E ngriti dhe në moment kërkoi dhe ai një gotë, ta trokasë dhe njëherë me shokun e fëmijërisë, pa copë të bëhet! -Paç ditë të gëzuara gjatë vitit 2011! -Më ke gëzuar që erdhe në shtëpi. Të paça me nder! E piu dhe i kërkoi dhe pak. Këtë gotë do ta pi për kushëririn dhe shokun tonë, Tamin. Lut Zotin t'i sjelli dritën e syve! Ke parë, o Tomi, sa herë të shoh ty, sikur shikoj edhe atë.

-Siç e kujton ti edhe ai ashtu të kujton.

-Po jemi të një gjaku, o Tomi dhe gjaku nuk bëhet ujë. Tomi, kam një brengë, ti, po të duash ma shëron. Ma sill një herë edhe atë Tamin. Më ka zënë malli... I premtova se më 7 janar e ke këtu.

-Është larg, më tha, po munde ma sill nesër!

-Jo më kot të thashë më 7 janar, se në këtë ditë kemi Shën Jovanin, ta këndojmë këngën si dikur, "Shën Jordhan, kur pagëzoheshë...". Vetëm ma sill, mos harro! Nuk vonova. I shkova në shtëpi.

-Pano, gëzuar këtë Vit të Ri! Më njohu nga zëri, zgjati duartë dhe më përqafoi. -Si e kalove këtë Vit të Ri, e pyeta?

-Mirë, mirë, me gruan, uruam njëri-tjetrin. Uruam vetëm shëndet se s'i kemi bërë njeriu keq! Më

gëzove që erdhe. Të pimë nga një gotë raki apo verë këtë Vit të Ri 2011! Irimi na solli gotat me verë dhe fillova ta uroj, por ai më pyeti:

-Kopin e urove? -Isha dhe e urova dhe të bën shumë të fala. U gëzua dhe më pyeti përsëri: -Si ishte? Kam shumë kohë, që s'e kam parë. E kishte marrë shumë malli, ka dëshirë të të shikojë. Do të bëjmë mirë, sikur të shkojmë një ditë së bashku. -Kur të duash, u përgjigj. Që tani, po të duash! -Jo, i thashë, më 7 janar ditën e Shën Jovanit do të shkojmë. Të zënë ashtu dorë për dorë shkuam te Kopi. E gjetëm përsëri rënë dhe Vali që i shërbente aty pranë.

-Ma solle Tamin, më pyeti, sa na pa? U mundua të ngrihet dhe me zor gëlltiti lotët dhe me gjysmë zëri tha: -Vali, afroma ta përqafoj! Tami u përul dhe u përqafoi me mall. -Kisha dëshirë, o Kopi të të shikoja me sy, por kështu qenka e thënë, unë të mos shikoj dhe ti mos ngrihesh dot! Me guxim do ta përballojmë këtë "dhuratë" të Perëndisë. -Na zuri e keqja, o Tami, unë nga këmbët dhe ti nga sytë! -Kopi, shok i dashur, e di që s'i kemi bërë njeriu keq. Qenka e thënë të vuajmë, por as ti, as unë nuk do të dorëzohemi. Guxim e shpresë, o kushëririn im!

-T'i lutemi Zotit, u thashë unë, që kemi të tre bashkëdhëtare të mira e të zonja. Ne sëmuremi, ato vuajnë më shumë se ne. Ngrini gotat për gratë tona, shëndet e gëzim paçin në këtë Vit të Ri!

## Fokus

### Pjesëmarrja Qytetare në procese elektorale

Prezantimi i projektit "Fuqizimi i praktikave demokratike të pjesëmarrjës aktive të qytetarëve në proceset demokratike", si dhe diskutimi i mënyrave të implementimit të kësaj iniciative në qytetin e Pogradecit. Ishin temat për të cilat u diskutua në tryezën e rrumbullakët organizuar në qytetin e Pogradecit në një nga ambientet e Hotel-"ROAJAL" më 19 janar 2011. Kjo tryezë u organizua nga Partnerët-Shqipëri, Qendra për

Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti (PSH). Ishin ftuar të merrnin pjesë përfaqësues të Pushtetit Vendor. Organizata të Shoqërisë Civile, parti politike, nga fusha akademike, media, biznesi dhe grupe të tjera të interesit për të diskutuar së bashku rreth çështjeve, që shqetësojnë qytetarët dhe që mund të bëhen object i fushatës së advokacisë, që do të organizohet në kuadër të Projektit gjatë procesit elektorale të zgjedhjeve të ardhshme të

Pushtetit Vendor. Ky projekt realizohet me mbështetjen financiare të Balkan Trust for Demokrecy, një projekt i Fondit German Marshall i SHBA. Prezantimi i projektit, qëllimi dhe problemet e dala për Shoqërinë Civile nga praktika dhe legji slacioni në fuqi i prezantuan zonja Juliana Hoxha drejtore dhe zonja Klodiana Tavani. Vazhdimi i këtij projekti përsëri në qytetin e Pogradecit mbështetet në përvojën e mirë në

këtë qytet nga viti 2001. Ky projekt do të realizohet edhe në rrethe të tjera të Shqipërisë. Në rrethet Berat-Elbasan shtator 2010-shtator 2011. Pogradec-Korçë janar 2011-shtator 2011. Zonja Klodi gjithashtu shpjegoi etapat e këtij projekti dhe puna konkrete, që do të bëhet në këtë qytet në kuadër të këtij projekti. Megjithatë pak diskutime dhe pak pjesëmarrës nga parashikimi, tryeza i mbylli punimet për t'u takuar në tryeza të tjera.

# Kufiri lindor dhe elitat

Nga Kofi Kyçyku

Lëvizja e kufijve lindorë gjatë shekullit të kaluar ndikoi në mënyrë vendimtare në “qarkullimin” e elitave në këtë pjesë të Evropës. Kjo dukuri mori jo rrallë aspekte tragjike, qysh në ditët e para të Pasluftës, sikurse ndodhi në rastin e zhdukjes fizike ose flakjes në qelitë e errta të elitave kombëtare në Shqipëri, Rumani, Bullgari etj, veçanërisht të personaliteteve politike dhe të intelektualëve që patën orientim kombëtar të qartë. Ky ishte genocidi i parë politik në historinë e Shqipërisë, çka në trevat lindore u parapri nga ajo që kryen bolshevikët rusë në emër të revolucionit të vitit 1917.

Seria e genocidit politik, që pat zënë fill me Revolucionin frëng të 1789-ës, tek ne arriti kulmin në dhjetëvjetshin e parë të regjimit komunist.

Me “qarkullim” të elitave kuptohet procesi i shkëputjes nga masa sociale e atyre që kanë cilësi të caktuara ose karakteristika të mirëdallueshme. Këta të fundit “grupohen” në një klasë të veçantë, të quajtur *elitë*, që ndodhet mbi kolektivitetin përkatës. Duke pasur parasysh se një numër gjithnjë e më i madh analistësh shprehen sot për një qeverisje botërore të planetit tonë, përveç *elitave lokale, kombëtare dhe kontinentale, kemi edhe ato botërore.*

Në procesin e “qarkullimit” dallojmë dy anë: *përzgjedhja* e disa individëve të pajisur me aftësi të caktuara dhe *grupimi* i tyre në një klasë të posaçme, e cila është e vetmja e thirrur për të udhëhequr shoqërinë. *I përzgjedhuri është njëherazi edhe i mbarëpranuar nga të tjerët. Sipas Vilfrido Pareto, njërit nga analistët më të njohur të kësaj teme, “... veçoria kryesore e termit “elitë” është ajo e epërsisë... Në kuptim të gjerë, me elitë të një shoqërie kam parasysh ata njerëz që zotërojnë cilësi zgjuarsie, karakteri dhe aftësi të çdo lloji, në çdo drejtim, me nivel të lartë” (V. Pareto, *Traité de sociologie générale*, 2 vol., Paris, Payot, 1933, vol. II, f. 1295).*

Shkëputja e elitës parakupton statusin e pjesës tjetër të popullsisë, e cila, gjithashtu, ngjiz një kategori të veçantë. “Kemi, pra, dy shtresa në popull: 1. *shtresa apo klasa*



*inferiore, e huaj për elitën...; 2. shtresa apo klasa sipërore, elita, që ndahet më dysh: a) elita qeveritare dhe b) elita joqeveritare” (V. Pareto, v.cit., f. 1298). Për vendosjen e secilit individ në njërin apo tjetrën kategori, nuk organizohen provime. Këto të fundit “zëvendësohen... me etiketa të caktuara... Për shembull, etiketa e avokatit nënkupton një njeri i cili duhet të njohë drejtësinë por që ndonjëherë nuk e njeh atë. Ngjashmërisht, në një elitë qeveritare përfshihen të gjithë ata që mbajnë etiketën e funksioneve politike dhe një rang të caktuar (bie fjala: ministër, senator, deputet, shef sektori në një dikaster, kryetar i Gjykatës së Apelit, gjeneral, kolonel etj.), përveç përjashtimeve të pashmangshme të atyre që ia kanë dalë mbanë të struken midis të parëve pa zotëruar cilësitë përkatëse të etiketës që kanë përvehtësuar” (Ibid., f. 1298).*

Pareto ishte i vetëdijshëm për “fuqinë” e etiketës së statusit (titullit). Gjithashtu, ai i referohej kësaj dukurie (e re në rendin historik) të ndarjes së cilësisë vetjake nga etiketa e pozitës, pra nga titulli që mban. Pareto i vesh kësaj dukurie një status të pazakontë. Në kuadrin e sociologjisë eurolindore, jo rrallë përjashtimi shndërrohet në rregull, pra qeveritarët bëhen zotëruar titujsh (etiketash), por jo detyrimisht edhe të cilësisë vetjake, që kërkohet për një funksionim të mirë të titullit. Ndërmjet titullit (etiketës së funksionit) dhe cilësisë vetjake, që

kërkohet për ushtrimin normal të funksionit, mund të zhduket çdo lidhje, çka e çoi Mihai Eminescu (1850-1889), - poetin kombëtar rumun, njëherësh analist i hollë i jetës sociale të kohës së vet, - të formulonte dy ide sociologjike: *teorinë e përzgjedhjes negative dhe teorinë e kompensimit*. Këto dy teori janë formulat sociologjike më adekuate për një shoqëri, si ajo komuniste, në të cilën përjashtimi fiton statusin e rregullit. Krejt sociologjia e elitës është e një mendjeje se elita është farkëtuesja e historisë, ndërsa masat i nënshtrohen aktit të qeverisjes, manipulimit, madje edhe dhunës së elitës. Mbrojtësit klasikë të kësaj teze janë V. Pareto, G. Moska dhe R. Michels. Sipas tyre, pavarësisht nga mënyra se si është marrë pushteti, ky, fill pas kësaj, kalon në duart e një “elite qeveritare”. Masat cilësohen si pjesa *pasive*, e manipulueshme, si bazë e rekrutimit të elitës, si një tërësi e publikut.

A. Etzioni (*The Active Society*, London, The Free Press, 1971, f. 113), në raport me masat, elitën e këqyr si mbartësen e “ndërgjegjjes aktive” të shoqërisë. Pò sipas tij, masa bëhet “aktive” në rast se elita i ofron “kontekste” për interpretimin dhe përdorimin e informacionit shoqëror. Mënyrat e të menduarit (kontekstet) dëshmojnë për llojin e elitave. Konteksti “instrumental” u atribuohet elitave “teknike”, ai normativ - elitave “intelektuale”, ndërsa ai shtrëngues, koercitiv - elitave “politike”. Ortegay Gasset jep përkufizimin kulturologjik të mëposhtëm për “revoltën e masave”: “*Shpirti mediokër, duke*

*e kuptuar vetë që është mediokër, guxon të afirmojë të drejtat e mediokritetit dhe t’i imponojë ato gjithkund”*. Që këtu del përfundimi se elitat i kundërvihen “mediokritetit të masave”.

Edward Shills e ngre konceptin e masave në një karrierë sociologjike spektakolare në teorinë e vet mbi zanafillën e “shoqërisë së masave”, ku, ndër të tjera, thotë: “*Për të parën herë në histori, agregate të mëdhenj qeniesh njerëzore, që jetojnë në një territor tepër të gjerë, mundën të hynin në një shoqëri relativisht të lirë, pa u shtrënguar*”. Veçoria e dytë e “shoqërisë së masave” është se, për të parën herë, falë saj, “qendra” simbolike e shoqërisë, - institucionet dhe vlerat e ligjësisimit, - është drejtpërdrejt dhe e lidhur ngushtë me “periferinë” sociale, domethënë me “masat” e mirëfillta.

Një dallojë tjetër e shoqërisë së masave është ekspansioni, pra përhapja e “kulturës primare” (lojrat, shfaqjet sportive, veprimtari me përmbajtje simbolike të kufizuar) në mbarë shoqërinë.


Të gjitha teoritë elitiste bëjnë dallimin midis një pakice të organizuar, racionale dhe një shumice të çorganizuar, që përbën masat. Elitës, pra, i vishet një rol pozitiv në histori, ai i shpëtimtares së masave. Në shoqërinë komuniste nuk funksionon korelacioni ndërmjet titullit dhe kompetencës (aftësive që kërkon titulli). Në këtë rast ligji i qarkullimit social nuk bllokohet, por ajo që do të qarkullojë nuk ka për të qenë tepria e një kapaciteti, por deficit i tij. Ky proces është quajtur *përzgjedhje sociale negative*. Elita komuniste është një vend akumulimi i deficitit social, i cili pasqyrohet në parazitizmin social. Të ashtuquajturën “elitë”, në këtë rast e përbëjnë elementë jokrijues, të pandershëm, spekulantë etj.

Elita me shenjën minus, - le ta quajmë kështu, - është ajo tek rreth së cilës grumbullohen individët, treguesit realë të aftësisë së të cilëve ndodhen nën nivelin e treguesve të kapacitetit, që kërkohen nga titujt e okupuar (“etiketat” që i korrespondojnë vendit të zënë në një klasë të shoqërisë). Elita e mirëfilltë, që i ka kushtet të afirmohet me të vërtetë, mbi bazën e meritokracisë, vetëm në një regjim demokratik.

Portret

-Një Homazh për Hysniun në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta-

# Model i përkushtimit për punë, korrektësi dhe virtyte të larta njerëzore



Hysni Fezollari

## Njerëz të vlerësuar të një krahine

Mokra është një trevë e njohur historikisht, por dhe etnikisht, për traditat e saj shoqërore dhe kulturore. Ajo është dalluar dhe dallohet për njerëzit e saj të mirë e të ndershëm, punëtorë e të palodhur, të mikpritjes, të këngës e të humorit. Natyra me resurset e saj u ka dhënë këtyre njerëzve bujarinë, ndershmërinë, sinqeritetin, duke u kthyer në modele të jetës shoqërore.

Këta mokratë dhe këta modele i gjen në jetën e përditshme të kësaj treve në të 31 qendrat e saj urbane. Në këto qendra jeta vazhdon rrjedhën e saj me të mirat dhe vështirësitë e saj.

Kalivaçi një nga qendrat e Mokrës së Sipërme, ku personazhi kryesor i shkrimit tonë është Hysni Baki Fezollari, trashëgimia e tij e vyer, që ka lënë pas, si model për fëmijët, familjen, të afërmit, por edhe për të gjithë ne. Por cili është Hysni Baki Fezollari?

### Pasaportë

Hysniu lindi në fshatin Kalivaç të Mokrës Sipër më 1 shkurt 1929 dhe u nda nga jeta më 24 shkurt 1991. Është i biri i Bakiut dhe i Xhevahires. Ai ishte një autodidakt

për çdo gjë, por në radhë të parë për të mësuar shkrim e këndim. Shquhej për një shkrim të bukur e të rrjedhshëm, të cilin e kanë trashëguar, të gjithë fëmijët e tij. Pas kryerjes së shërbimit ushtarak të detyrueshëm në reparte këmbësorie në Tiranë, kryen një kurs ekonomik në qytetin e Korçës.

Kryen fillimisht detyrën e ekonomistit dhe më vonë atë të shefit të llogarisë në ish-kooperativën bujqësore të Podkozhanit.

Me krijimin e ish-Kooperativës së Bashkuar me qendër në Trebinjë, kryen detyrën e brigadierit e mandej të përgjegjësit të sektorit deri në momentin e daljes në pension. Jeta dhe figura e tij morale shërbeu dhe vazhdon të shërbejë si model përsosmërie për të pestë fëmijët e tij: Fahriu, Selamiu, Selvikua, Zeni dhe Mimoza, por edhe në memorijen e të afërmeve, miqve, shokëve, vëllait Kudreti, të nipërve, mbesave, që nuk janë të paktë dhe e kujtojnë atë me admirim...si prind, bashkëshort, si vëlla, si mik, si shok të vyer.

### Njeriu që la pas një jetë model

Njeriu vjen dhe ikën nga kjo botë si qenie e gjallë, që lind, rritet e formohet në kushte të caktuara të një shoqërie dhe vepron në të. Me veprimtarinë e tij ai lë gjurmë të pashlyeshme tek ata, që e rrethojnë dhe tek ata, që kanë marrëdhënie dhe raporte të caktuara me të. Një ndër ta është dhe "personazhi" i nderuar i shkrimit tonë, Hysni Fezollari.

Ai nuk jeton më fizikisht, e megjithatë, shfaqet në memorien vizive të kohës dhe të atyre, që e kanë njohur, kanë punuar, kanë qeshur, kanë biseduar, pse jo dhe kanë këmbyer urimet dhe gotat e rakisë me miqtë si mokrat të vërtetë. Nga testimi ynë në opinion për këtë figurë publike, pothuajse kemi marrë të njëjtat vlerësime. Do

ta themi me bindje, nëse do të vazhdonim akoma, jo vetëm në fshatin e lindjes Kalivaç, por edhe Podkozhanin, si fshati më i afërt dhe më bashkëpunues për atë komunitet, do të vazhdonin të evidentonin vlerat pozitive të tij.

Por ne morëm mendimet, përshtypjet, opinionet e njerëzve të tij të afërt dhe kjo është e natyrshme, pasi ata kanë qenë më afër. Kështu u shprehën zotërinjtë Feim Jasharllari, nga i njëjti fshat, kryetar aktual i komunës Trebinjë, specialist i lartë në fushën e Bujqësisë, kuadër në ish-Kooperativën e Bashkuar, vëllai Nazifi dhe Kudreti dhe njëri nga djemtë e tij, Zeni, ushtarak në lirim.

*Feim Jasharllari*- Nëse kërkoje një gjerman për ta pasur si model të punës, të korrektësisë, të disiplinës e të drejtësisë, kishe Hysniun. Ai realisht në çdo kohë vendoste interesin e përgjithshëm mbi atë personalin. Shquhej për korrektësinë, por edhe për humorin e tij të hollë e të ëmbël në këto dy fshatra. Ishte një njeri kundër veseve të këqija në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë kundër duhanit dhe alkoolit. Burrat e Kalivaçit, sipas gojdhënës, me origjinë nga Labëria, sa kanë të përbashkta, kanë edhe të veçanta dhe shquhen në zonë: xha Bakiu simbol i humorit dhe i mendjes së hollë, xha Demiri i mençuri i fshatit, xha Sulka burrë tabani e kështu me radhë...

-Ka qenë person i veçantë në karakter, i filloi mbresat e tij, vëllai Kudreti, duke u munduar të mbante lotët, për fjalën e dhënë dhe mbajtjen e saj, por ai mbahet mend dhe për humorin pa të keq, me të gjithë. Hysniu ishte një kursimtar, që dinte ta ruante dhe ta përdorte me nikoqirllëk paranë dhe ishte në çdo kohë i gatshëm për të ndihmuar kush të kishte nevojë.

Sëmundja deshte ta mposhte, por e kish të pamundur, pasi ishte me vullnet të jashtzakonshëm, e përballoi deri në minutat e fundit.

Por jo vetëm kaq, ai ishte një mik i vërtetë. Këtë e vërtetojnë ata, që kanë qenë miq në këtë shtëpi. Dashuria e sinqertë për ne vëllezërit dhe motrën e vetme Rrushkën, niprit e mbesat ishte një cilësi tjetër e karakterit të tij. Ai nuk u bë asnjëherë anëtar i PPSH, pasi në të nuk shikonte njerëz serioz e model, siç shquhej e duhej të ishin. Po çfarë kujton dhe ruan sot si "të shenjtë" nga babai, djali i tij *Zeni*?

-Më të mirat, që mund të thuhesh dhe këtë e them me gjithë shpirt. Kërkes, por edhe tolerant. Dashamirës i përkushtuar për arsimin, gjë, që vërtetohet me arsimimin e fëmijëve: dy me arsim të lartë (Moza e Zeni) dhe tre me arsim të mesëm, megjithëse në kushte jo të mira ekonomike. Ai kishte një kërkesë të fortë ndaj vetes, por edhe ndaj nesh, i përkushtuar dhe ekzigjent për çdo gjë. I drejtë, i ndershëm, si rrallë të tjerë.

Ai në sytë tanë dhe në memorijen tonë sot mbetet model i një prindi dhe bashkëshorti model edhe për ne. Këto raporte dhe këto marrëdhënie i ruante edhe me të tjerë.

Të gjitha këto formojnë figurën morale dhe publike të një njeriu të thjeshtë, që ishte dhe mbeti model për veten, për familjen, për fëmijët, por edhe për të tjerët. Një nga ish-kryetarët e ekonomisë është shprehur: Po t'i kishim të gjithë kuadrot si Hysni, që punon me ndershmëri e përkushtim, me gjithë mungesën e resurseve, do të konkurronim denjësisht dhe ekonominë e Buçimasit. Dhe për këtë fëmijët dhe të afërmit kanë të drejtë të krenohen dhe të ecin të sigurt në rrugën, që u tregonte Ai, Hysni.

Le të shërbejë ky shkrim një homazh përjetësie nga njerëzit e dashur të tij, por edhe nga ne, që kemi patur fatin ta njohim atë nga afër!

*Dhimitër Gegprifti*

*Nga Bedri Alimehmeti*

Kisha disa ditë që puna nuk po më ecte. Ulesha në tryezë i vendosur që nuk do të ngrihesha pa i dhënë fund edhe një tregimi. Por, qe e pamundur, më kot mundohesha, gjithçka hidhja, jo, nuk më pëlqente, por nuk më ngjiste fare. Shkurt ndihesha i shqetësuar dhe i mërzitur ngaqë po vononte përfundimi i ciklit “Tregimet e Tiranës”, të cilëve në këtë vëllim të parë ua kisha taksur numrin nëntë. Kaq kishte qenë dëshira ime e kahershme, ndërkohë kisha përfunduar tetë prej tyre, disa nga të cilët i kisha botuar në shtypin letrar dhe kisha ngecur.

Jo se më mungonin subjektet, përkundrazi në shënimet e mia kisha disa synopsis, të cilët edhe pse i nisja e kisha të pamundur t’i çoja deri në fund. Ndaj në shtjellën e këtij shqetësimi, sidomos ngaqë nuk po arrija ta bëja librin gati në kohën e duhur, u sorollata atë ditë nga njëra kafene në tjetrën deri sa tek po shëtisja bregut të Lanës u përballa me një shokun tim të fëmijërisë. Kishim vite pa u takuar ndaj e patëm të pamundur të shkëputeshim nga njëri-tjetri, pa ndenjur e biseduar gjatë. Zume vend në një kafene aty pranë dhe nisëm bisedën.

Ai kishte kohë që më ndiqte në shtyp, në radio e në televizor, madje i kishte lexuar të gjithë librat e mi, dhe në fund të ligjëratës më pyeti se, “çfarë kisha në dorë?” I tregova, madje i shpreha edhe shqetësimin, që jo pak po më mundonte ato ditë, teksa ende nuk po e çoja deri në fund atë çka i kisha vënë detyrë vetes, dhe kur i thashë për titullin e librit të ardhshëm, atij i bëri përshtypje ndaj më pyeti: “Përse ju tiransit i thoni Tirona dhe jo Tirana qytetit tuaj?”. Atëherë u detyrova t’i rrëfeja këtë histori.

Të njejtën pyetje thujse si kjo e jotja, i thashë ia kishte bërë një ditë Lasgush Poradecit edhe miku i tij, arkitekti Petraq Kolevica, që nuk harronte ta vizitonte shpesh në atë banesën e thjeshtë në atë lagje

periferike të Tiranës, ku banonte poeti ynë i madh. Për mua Lasgushi është padyshim një nga mendjet më të ndritura, që ka nxjerrë ky komb. Ai shkroi pak, por na la shumë. Lasgushi vërtet nuk ishte nga Tirana, por fakti që ai kaloi në këtë qytet një pjesë të mirë, ndoshta më shumë se gjysmën e viteve të jetës, pa thënë se gjatë gjithë kësaj kohe jetoj mes tiranasve, në një shtëpi të familjes së nderuar Mumajesi, në lagjen “Xhamia Sherif” (sot lagja nr.1), ku bashkë me ta përballoi halle e vështirësi të panumërta, teksa përkulur ditë natë mbi makinën e shkrimit, për të siguruar bukën e gojës duke na sjellë në shqip poetët më të mëdhenj të botës, “ky hamall i përkthimit” siç e quante ai veten, bëri të mundur krijimin e shumë fijeve të padukshme, që e lidhën përjetësisht me banorët e kësaj treve të begatë e të pafund në vlera njerëzore. Madje, ai i deshi shumë, por edhe ata ama e nderuan dhe e respektuan pamasë.

Kudo që ta shihnin e përshëndetnin, qëllonte të ishte me një trastë në dorë, sigurisht pasi kishte psonisur diçka, ia merrnin nga dora dhe ashtu duke biseduar me të e përcillnin deri te porta e shtëpisë. Kur ia ndjenin trokitjen e bastunit nëpër pllakat e trotuarit ndaleshin dhe i hapnin udhën, teksa ai u dhuronte pambarimisht buzëqeshje të këndshme. Mahniteshin sidomos nga pamja e tij ngazëllyese në ditët e para të pranverës, kur pemët çelnin lule, zogjtë cicëronin gazmorë, mimosat të dehnin me kundërmimin e tyre, kurse Dajti dukej sikur i afrohej edhe ca më shumë qytetit, tek e shihnin të ecte i rinuar brigjeve të Lanës me kapelën karakteristike dhe pardsynë e hirtë shtrënguar në mes.

Në raste të tilla nuk i afroreshin, e linin ashtu të qetë në përjetimin e atij meditimi poetik. Sigurisht e ndjenin që poetin tashmë se ndalte kush nga shuarja e atij përvëlimi të pakrahasueshëm malli për liqenin dhe qytetin buzë tij. Madje, e dinin që edhe pak ditë, ja sa të ngrohej ca moti, ai do të merrte rrugën për

# Lasgushi dhe Tirona



të mbërritur sa më parë atje. Dihet nga të gjithë, Lasgushi gjashtë muajt e dimrit i kalonte në kryeqytet, kurse gjashtë muajt e verës buzë “gjolit” në Poradecin e tij të dashur, të cilit i tha gjithnjë kështu dhe kurrë Pogradec.

Gjatë kohës kur ishte në Tiranë e vizitonin herë pas here shokët e miqtë e tij të pendës: Mitrush Kuteli, Nonda Bulka, Eqerem Çabej, Andrea Varfi, Petro Marko, Mustafa Greblleshi, Sterjo Spasse dhe Petraq Kolevica. Këta ishin miqtë e ngushtë të Lasgushit, të tjerë nuk qaste në shtëpi. Kur puqeshin të gjithë tok dhe biseda ngrihej në nivel të atillë, që do t’ia kishin zili edhe profesorë të shquar universitetesh, tiranasi Mustafa Greblleshi, të cilin poeti e donte aq shumë thoshte gjithnjë: “Kjo është Akademia Lasgush Poradeci”.

Vetëm pak pasi ishte kthyer nga një shëtitje e tillë, kishte mbërritur atë ditë Petraq Kolevica, që pasi i tregoi disa poezi të përkthyer nga

gjermanishtja në bisedë e sipër i tha:

- Ama dhe këta tiranasit, nuk ia thanë një herë tamam emrin Tiranës, qytetit të tyre, por gjithnjë Tirona, Tirona!

Lasgushi e kishte parë gjatë në sy dhe më pas kishte dhënë këtë përgjigje:

- Që duhet ta kenë një arsye që i thonë Tirona e jo Tirana qytetit të tyre, unë nuk e diskutoj. Them kështu sepse, e di mirë që ky popull bujar ka qindra vite, më saktë shekuj që e quan kështu qytetin e tij. Dhe arsyeja kam mendimin se vjen pikërisht nga thellësia e shekujve.

Arkitekti u step për një çast, aq më tepër kur vuri re që nga sytë e poetit kishte nisur të fekste vezullimi i një drite të paparë. Gjithçka ishte e qartë, “masati” i mendjes së tij pritej të shkëndijonte sërish, madje edhe më fuqishëm.

*vazhdon në faqen 9*



vijon nga faqja 8

# Lasgushi dhe Tirona

- Ty të shqetëson shumë mbaresa "ona", por duhet të dish që Perëndesha e lashtë e ilirëve, pra e të parëve tanë ishte Dodona. Madje, enkas për të ata ndërtuan tempullin e Dodonës, ku vinin dhe i faleshin për ditë. Në Jug të Shqipërisë kemi një qytet shumë të bukur buzë detit, mu aty ku ndahen dy detet e mrekullueshëm Joni dhe Adriatiku. Ai qytet sot quhet Vlora, por emri i tij i lashtë është Aulona. Po të shkojmë në Veri dhe të ngjitemi në alpe, atje mes Bjeshkëve të Namuna kemi një lumë me bukuri përrallore, që quhet Valbona. Pra, edhe këto emra me "ona" mbarojnë. Dhe ne na pëlqen dhe i duam shumë. Por, nuk mbaron këtu llafi im. Po të kalosh detin Adriatik dhe të zbresësh në brigjet e Italisë ke një qytet mjaft të bukur, që mban emrin Ankona. Kurse në veri të Italisë gjendet një qytet tjetër me emrin Verona, qyteti i Romeos dhe i Zhuljetës. Dhe italianët me sa di deri më sot, nuk janë jo shqetësuar por, as ankuar që emri i qytetit të tyre të mrekullueshëm mbaron me "ona". Pas kësaj Lasgushi e ndali

fjalën dhe mori frymë thellë. Kundërmimi i aromës së selfijonit ose borzilokut siç i thoshte ai të sapoçelur nëpër vazot e radhitura me kujdes anës murit ia zgjeroi edhe më shumë kraharorin. Arkitekti i zënë disi ngushtë pande hu se poeti kishte mbaruar dhe desh të shtonte diçka, por ai ia bëri me dorë të priste.

- Nuk kam mbaruar, kam edhe më, - shtoi poeti - po të përmend edhe dy emra qytetesh nga më të bukurit në Europë. Madje, njëri prej tyre është kryeqytet Lisbona dhe tjetri Barcelona. Po gjithësesi këtë herë do të jemi sërish në Shqipëri në dheun e Arbërit, ku plot vajza të bukura quhen Elona, Bleona, Jona, Edona, Emona, Ermiona etj. Gjithë këta emra bukurish të rralla vijnë nga lashtësia dhe mbarojnë me 'ona'. Dhe neve na vjen mirë dhe i gëzohemi pamasë yllësisë së tyre. Ndaj dhe ky popull i urtë e punëtor, mikpritës në kulm, dashamirës e bujar, që nuk di të përgojojë askënd e ka një arsye të fortë që nuk i thotë kurrë Tirana, por Tirona qytetit të tij, të cilin sigurisht e

dashuron më shumë sesa ne dhe jo vetëm. Unë kaq di të them, të tjerat kanë për detyrë t'i bëjnë historianët, arkeologët e gjuhëtarët, të cilët duhet të hulumtojnë, të kërkojnë e të gjejnë arsyen e vërtetë. Kaq kishte nxjerrë nga "masati" Lasgush Poradeci dhe kishte heshtur.

Brenda pak çastesh në mënyrë të habitshme perceptimi i tij qe zhytur në thellësi të paimagjinueshme e të mistershme të shekujve, duke vërtetuar kësisoj edhe një herë potencën e pakrahasueshme që karakterizonte analizën e tij zhbiruese prej gjeniu.

- Tregim i bukur shumë! - foli bashkëbiseduesi im.

- Cili!? - i thashë i habitur.

- Ky që sapo më tregove. Dhe kot e vret mendjen për të shkruar tregim tjetër. Ja tek e ke. Siç ma tregove, shko e hidhe në letër. Madje, me të do të parandalosh kundërvëniet, meqë ke përdorur në vend të Tirana, Tirona.

Shoku kishte plotësisht të drejtë. Ndaj dhe unë, merreni si të dëshironi e vendosa këtë histori si në vend të një "parathënie", në krye të këtyre tregimeve për Tironën.

Por, pa harruar kurrësesi t'i përulem në këtë rast me respekt madhështisë së fjalës lasgushiane. Faleminderit poet i liqenit. Nderim për ty Lasgush Poradeci "shterg i fundit" i poezisë së vërtetë shqipe, që aq shumë i deshe tiransit e mi.

Marrë nga vëllimi në proces botimi: "Tregimet e Tironës" (1)

====

Bedri Alimehmeti -

"*Fisnikëria tiranase*".

Gazetar e shkrimtar, autor i shumë librave ndër të cilët përmenden:

"*Tirana e përgjakur*" (2001), "*Venusi perandorak*" (novelë 2002),

"*Natë madrilne*" (tregime 2004),

"*Skënder Halili, vezullimi i një ylli*" (biografi 2008),

"*Gjigandi Arben Minga*" (biografi 2009) etj.

Libri i tij më i fundit është "*Shyqyri Rreli, një jetë për futbollin shqiptar*" (biografi 2010).

Art

## "Ditë Dimri", Pogradec – 2011

*Ekspozita Mbarëkombëtare e Artit Figurativ*



Një tjetër aktivitet u promovua në Galerinë e Artit të Qendrës Kulturore "Lasgush Poradeci" më 21 janar 2011. Në prani të qytetarëve dhe artdashësve të këtij qyteti u çel Ekspozita Mbarëkombëtare e Artit Figurativ,

bërthamën e tij dhe që është Ekspozita e Arteve Figurative, por që synon të jetë një lloj i hapur edhe për njerëz të fushave të tjera të arteve: letërsisë, poezisë, fotografisë, arkitekturës, por edhe koleksionistëve dhe dashamirësve

titulluar: "Ditë D i m r i" - Pogradec 2011. "Ky aktivitet është konceptuar si një aktivitet i hapur, i lirë, me një aktivitet qendror, që p e r b e n

të artit, pa përjashtuar aspak dashamirësit e vetë qytetit të Pogradecit".

Në këtë aktivitet prezantojnë punimet e tyre piktorë të afirmuar në shkallë kombëtare dhe më gjerë... Shtrirja gjeografike e këtij aktiviteti është e pakufizuar, në vitin e dytë të tij, si një nevojë për komunikim dhe si një domosdoshmëri reflektuese për secilin artist.

Promovimi i qytetit të Pogradecit edhe në ditët e bukura të dimrit është një synim tjetër i këtij aktiviteti me këto përmasa. Në këtë edicion kemi emra të shquar piktorësh, si: Abdurrahim Buza, Sadik Kaceli,

Guri Madhi, Adem Kastrati dhe Ismail Lulani. Midis tyre janë edhe punimet e artistëve pogradecarë. Kjo ekspozitë do të qëndrojë hapur për disa ditë për të gjithë artdashësit.



# Konkurrentët e konkursit të përvitshëm poetik on-line “Nositi”

## Online me Zeusin

Bota luhartet nën avuj mëngjesi  
Avujt zbresin nga Olimpi.  
Mëngjesi ka fytyrën e tim biri,  
Dhe aromë n e Zeusit...

Mbrëmë unë fjeta me Zeusin..  
Më saktë u zgjova me Zeusin  
në shkallë të mermerta pasioni,  
Ndërsa ujëraa dritash  
përmbytin minutat...  
Pasioni kapërthen trupat tanë  
qendra e botë s' është gjoksi im  
busulla regëtin në mençurinë e  
tij.

Ha haaaaaa. Zeusi im  
Çuditërisht ka aromë gruri  
Te gropëza e supit i flenë  
erërat e detit.  
Juga ime paqëtohet në  
përkëdheljen e burrit.  
Dhe vishem me ngjyrat e  
qeshura të ditës.  
E portokallta shkrihet në të  
gjelbërtën e syve të tij..

Shtëpia me kangjellat e  
gjelbërta,  
ku takohen dhe miqësohen  
erërat e ishujve,  
dhe dritaret e drunjtat e të  
gjelbërta,  
hyrjet me shkallë prej valëve të  
detit  
deri te muret me ikonat e  
vjetra,  
ku Gjon gojarti apo ioanis  
pagëzori flirton  
me buzët lutëse...  
Shtëpia e gjelbër,  
Del nga kujtesa e peshqve,  
Lazdrohet si rrezja në valët e  
Jonit  
Vajza të panjohura i dhurojnë



Zeusit tim  
Iriqë deti, si ngërçe ndjesish të  
fshhehta,  
I shoh si Herë hakmarrëse dhe  
i paqtoj në ikje.

Zeusi im thotë, se kam lëkurë si  
qumështi  
aroma e ime i rikthen kuzhinën  
me erëza.

Gjyshen me gërsheta dhe  
vrapimin e lirë nëpër fushë.  
Unë i thëthij të gjelbërtën e  
butë të syve dhe zhytem në  
Gjoksin e ngrohtë,  
harrohem, aty...  
Qetë s'ia bie mbi trupa,  
Zeusi im merr formën e  
shigjetarit,  
dhimbja ndjellëse,  
Ngërthen habitshëm me ngjyrat  
e verës.  
Gugatjet bien si kopsa të kuqe  
fustani,  
rrokullisen në mermerin e  
germave  
dhe falen në këmbët e shenjtit  
të lënë në errësirë.

Zeusi im thotë, se kam sistem  
të ndryshëm nga Olimpi  
i rremë.  
Unë i gëzohem nanurisjes mbi  
vale..

*Laureta Roshi*

## Hapa mbi gjethe

Tek shkel mbi gjethet e verdha  
Padashur nga gjumi i ngre.  
Fustani i blertë i pranverës  
Kërkon të shtrihet mbi ne!

Mbi mua një mall spërkat  
Fytyrën time të ngurtë!  
Skicova vjeshtën e verdhë  
Dhe hapat mbi gjethet u tretinë.

Nuk ka më lule tani.  
Kjo stinë i hëngri me uri!  
Pranvera prap do buis  
Po ti a do dalësh përsëri?

*Besnik Bedollari*

## Mbushma natën me ëndrra

Në përhumbjen e qiellit të  
trishtë,

Në çudinë e fajshme të së  
pafajshmes,  
gishtat e dy pëllëmbëve të tua,  
lënë gjurmët e përdala  
ledhatonjëse,  
duke harruar mëkatën e parë,  
të dytë,  
të tretë...  
në murin e mermertë të dy  
shegëve që kuqëlojnë.  
-.-  
Në parvazin e shtratit të  
argjendë,  
fillojmë të numërojmë ëndrrat;  
si shtegtarët e natës në  
kafazet  
e kumrijeve,  
nisim të ringjallim filizat me  
vesë  
dhe në mëngjeset e  
përflakura,  
shtrati ynë është përplot me  
ëndrra  
si shporta me trëndafilat në  
belin e drenovares.

*Raimonda Moisiu*

## Tjetërsim

Në ligotë të floringjtë kisha  
të vetmen shoqe mondane

Ma grabiti koha e kulisave  
ma veshën me mantelin e tyre

Jam gjysma-pjesë e mbetur  
si dre i plagosur në shpirtin tim

Tani ajo s'është me as jetësore  
e jo me rrjedhë dashurie jo e  
jo.

*Illir Cane*

## Orët e lamtumirës

rënkim  
dënesë  
as fjalë  
as heshtje  
as ikje  
as asgjë

orët e lamtumirës  
të dhimbjes  
të fjalëve  
të heshtjes  
të ikjes  
të asgjësë

këto orë ishin të lamtumirës  
orë të ikjes  
Për ku?  
Për se?  
O Zot ç'botë?!

*Alide Lloga*

## Nostalgji mëngjesi

Pak nostalgji e kohës së shkuar  
papuritur këtë mëngjes  
më pushtoi zgjimin.  
Ta quaj ëndërr këtë vegim  
që nga larg trokiti? Nuk e di.  
Ishte vjeshtë kur sytë tanë  
rëshqitën lehtas shikimin  
ato ditë shtatori,  
dhe zemrat, ngatrestaret e  
pabindura,  
thurnin dashuri.  
Sa keq, vërtet sa keq  
që vitet kaluan kaq shpejt  
dhe ditët e pafundme të  
delireve  
më nuk kanë trokitur.  
Mos ki frikë nga kujtimi im,  
harroi ato çaste, se unë nuk  
skuqem nga largimi  
dhe nga e brishta xheloz  
nuk digjem.

*Arjan Kallço*

## Të jemi njëjës shumë!

jemi shkrirë  
në njëri-tjetrin

s'bëhet fjalë të merremi  
për njësi të veçanta individuale

jemi një Shpirt i vetëm  
ndonëse dy trupa  
të vendosur në dy vende të  
ndryshme  
të të njëjtit Planet

pjesë të pandashme  
të të njëjtit identitet

*Prafulla Kumar Sahoo*

## Shpit binjak

zemrën time e zbraz  
e pastroj

këtë kovë me hirin e një zjarri  
që nuk arriti lartësitë

e fshij deri në shkëlqim  
me lotët e fillimeve

# Konkurrentët e konkursit të përvitshëm poetik on-line “Nositi”

të pashuar dhe  
të pashueshëm kurrë  
më pasqyrojnë sytë e tu

sa më ke munguar  
në ishullin tim të largët

më në fund  
jam kthyer

*Silke Liria Blumbach*

(...)

të kam...  
më ke...?  
të lutem thuaj...  
ç'të jam...  
më je...  
shshsht, vetëm duaj...

se unë...  
se ti...  
se ne të dy...  
nuk mund...  
nuk di...  
ç'do ish pa ty...

*Doreida Gedaj*

## Pritja e saj

Të prita, të prita aq gjatë  
sa zemra ime për ty ndjeu mall  
u dogj ajo me prush e me flakë  
në fund pikoi disa pika gjak,  
por unë i thashë prit, prit dhe pak

sa ta mbaroj këtë të uruar varg.

*Dorjana Bezat*

## Kështu foli Odisea

Ja ku u ktheva, e imja  
Penelopë  
Uro të drunjtin Kalë, për këtë fat  
Që mendja ime polli për një Trojë  
Trojë  
Dhe pjella polli shkatërrim e gjak.

Oh, të paskam plakur,  
Penelopë!  
Vetë si e harrova pleqërinë?  
Ti me një pëlhurë ç'bëre kohë  
Unë me një Kalë ç'bëra rininë.

Nuk di pse më prite, Penelopë  
Për dashurinë që luftës ja dhurua

Për fronin mbetur bosh pa të zonë

Që qasësit e tjerë s'e merituan?

Nuk di kë Odise tani do duash  
As unë nuk e di kë Penelopë  
Veç di, dinakërinë që krijuam  
Do lemë trashëgim në këtë botë.

*Edmond Shallvari*

## Shtoi Zot Vallet

Shtojzovallet e dhimsura,  
Kaq panë në botën e njerëzve  
Në një vizitë,  
Shumë më te shkurtër se rruga

Gjithçka u dukej makth ëndrrë,  
makth drite  
trupëzuar tek një flokëverdhe si  
shtojzovallet  
Ulur në hijen e zonjave të shtëpisë

Duke thurur gërsheta  
tatuazhesh zhgënjimi  
Të tepruara nga një natë më parë

Në pritje të  
“MIRËMËNGJESIT” të shtojzovalleve

Duke u ngjasuar me veten,  
Me frymë i lanë trupin,  
Me qerpikët e gjatë i krehën flokët,  
Zërat dhe dritat ia qepën mantel,  
Duke e bërë simotrën e tyre

Nën ritmin shtojzovall:  
”SHTOI ZOT VALLET”  
Shtojzovallja e re kërcente  
Duke argëtuar dhe tatuazhin e zhgënjimit...

*Irena Gjoni*

## Në krah mora zemrën time

Krenarinë e vështa sot  
dhe me të fillova ditën  
ma kish dhën zoti kish mot  
por unë sot lejova dritën.

Dritën hapa, ore mik  
gjeta çelësin n'errësirë  
ndala frymën në rrezik  
për t'u ndje paksa më mirë.

Hapa dritën, fshiva sytë  
u bëra shok me çiltërsinë  
zemrën lëshova n' këtë jetë  
siç lëshojmë një pëshperimë.

Në krahë mora zemrën sot  
ajo sytë i kish të mpirë  
me tik-takun rrinim tok  
duke gdhendur lot të ngrirë.

Eca e eca brenda vetes  
e veshur me krenarinë  
thirra dritën t'i pri jetës,  
tek unë e kish bërë shtëpinë!

E vazhdova udhëtimin  
pa e ndalur mendjen kurrë  
njihja veten dhe qëllimin  
vdekja u zu në çark nga unë.

Jeta ime më është dhuruar

Veç me dritën vezulluese  
me dashurinë e zburuar

Krenarinë e ka bërë nuse!  
*Monika Bakshevani*

## Plaku në Facebook

**Plaka:** Paf e puf me atë çibuk,  
me qelshen kthye mënjanë,  
po le nam nëpër face book  
boll se çudite dynjanë...

**Plaku:** Rri, moj plakë,  
se ti s'merr vesh,  
mbete e fundmja e miletit.  
Sot s'është koha  
me tjerrë lesh,  
por është koha e internetit.

**Plaka:** Me këtë furkë  
e me këto dele,  
unë kam mbajtë burrë e shtëpi,  
ndryshe kishe mbetë me zhele  
e s't'i hidhte sytë njeri.

**Plaku:** Unë për gusto  
e ndjekje mode,  
jam i pari në katund,  
do ndryshojë dhe pamja jote  
kur të të vesh me minifund.

**Plaka:** Të ka ikë truri,  
mor qyqar,  
Nuk e di se ç'të ka gjetë,  
në vend që të punosh në arë  
rri gjithë ditën në internet.

**Plaku:** Moj shushmane



me lerë rehat  
më mirë shko me dele në pyll,  
se më ka hyrë njëra në chat  
qenka e bukur porsì yll.

**Plaka:** Ti, mor plak  
më quan të marrë,  
por e kam unë një azgan,  
më çon mesazhe në celular,  
kur përcjell dhentë për në stan.

**Plaku:** Të lumtë, moj plakë,  
se fole mbarë,  
sheh çka bën teknologjia?  
Me facebook e celular  
hidhet prapa kralesh pleqëria.  
*Ndue Lazri*

## Qumesht Sirenash

Erdha e ika, ika dhe erdha...  
Asgjë nga ç'kerkova nuk  
gjeta...!  
Asgjë ndryshe nuk doja të jeja!  
Asgjë që të ç'bëja qenien  
tënde!  
Asgjë që të ndryshonte timen  
qenie...!  
Ika, ika në mes të ikjes  
përsëri...!  
Asgjë që të më mbante...!  
Asgjë

që të më thoshte se je...! Asgjë  
që të më bënte të isha i  
veçantë...Asgjë  
... që të më pengonte këtë  
timen lënie...! Të lashë aty ku  
të gjeta! Herë  
në tokë e pa tokë...! Herë në  
qiell e pa ajër...! Shpesh mbi  
varkë në det të  
hapur...Gjithmone në vdekje-  
qetësi e pa kallur...! Ika  
të notoj ku ka dallgë...! Të më  
marin brënda tyre si një  
delfin...Të pi ujë deti, të dehem  
me sirena...Të sëmurem me  
mjaltin e tyre...Të vdes kur e si  
ma ka ënda...!

*Arben Pambuku*

# Optika e vlerave dhe vlerat e një studiuesi

Nga Dhimitër Gegprifti

-vështrim kritik për botimin: "Ringjallet Rilindja e Lasgushit- Po Unë?, autor P.Prifti



Të studiosh dhe të japësh gjykime për botimet e studiuesit Petro Prifti për problematikat e tyre, për mendimet e tij, qëndrime e vlerësime të caktuara, nuk është e lehtë.

Nga një vështrim i kujdesshëm, vihet re se botimet e këtij studiuesi kanë karakter vërtet shkencor, ku thuajse ngjizen të gjitha shkencat. Ato nuk u përkasin gjinive letrare, që mund t'i lexosh në çdo kohë pa vështirësi.

Në këtë përfundim arrijmë, kur kemi parasysh dhe objekt të vështrimit tonë botimet: "Dashuria e ka princin e saj", "Rilindja e Lasgushit", "Gjokë Risto Kondakçi", "Mendime për mendimet-Dashuria, Unë dhe Ti", maj 2008, "Jetë me luftë" dhe "Ringjallet Rilindja e Lasgushit-po Unë?", mars 2009.

Këto botime duhen parë të shkëputura, ashtu siç janë në fakt, nga botimet me karakter shkencor, metodik, pedagogjik në fushën e shkencave ekzakto.

Botimet në fjalë janë të karakterit social-biografik (Jetë me luftë), "Gjokë Risto Kondakçi".

Ndërsa të tjerat me karakter letrar: "Dashuria e ka princin e saj", "Rilindja e Lasgushit" dhe "Ringjallet Rilindja e Lasgushit- Po Unë?" dhe një mikroenciklopedi e filozofisë popullore dhe e njerëzve të mëdhenj, me një tematikë kryesisht Dashurinë, si një kategori filozofike dhe sociale.

Të gjitha botimet janë të Entit Botues "DIJA-Poradeci". Ato të grishin jo vetëm nga titujt intrigues, por edhe nga tematikat dhe problematikat e tyre. Së pari do të nënvizonim se kjo ndërmarrje kryhet nga specialist i një fushe tjetër: matematika, fizika, filozofia.

Stili i autorit është i ngjeshur, konçiz, shpesh me nëntekst dhe me pyetje retorike, me një terminologji, pothuajse nga të gjitha fushat: matematikë, fizikë, filozofi, astronomi, biologji, gjuhësi, folklor, letërsi, teori letërsie, Bibël, Kur'an.

Së dyti do të nënvizojmë faktin se P.Prifti ngre dilemat: pse botimet e tij nuk janë objekt i kritikës artistike dhe njëherësh vlerëson negativisht një grup autorësh. Një pjesë syresh vlerësohen negativisht në citimet e mëposhtme: "Libri im "Rilindja e Lasgushit" ka mbetur pothuajse i paprekur nga kritika, me sa duket ajo FATKEQËSISHT, nuk është e aftë të merret me probleme e vlerësime të thella, prandaj më lindi ideja e botimit të Ringjalljes së tij", f.5. "...nuk është botuar një monografi e plotë shkencore për veprën e tij". f.10, "Kritika ka qenë skuadra e pushkatimit të 9-të Lasgushëve, për të cilët nuk mund të thuash "punë e madhe", sepse njerëzit e mëdhenj janë prika e Kombit, janë krenaria e tij...të luash me Kombin do të thotë...". f.191. Në vlerësimin tonë nuk do të merremi me vlerat, analizat, qëndrimet dhe vlerësimet për veprën letrare të Lasgushit, pasi

ato do t'i takonin një punimi tjetër të specializuar në fushën e letrave.

Nga një vështrim i përgjithshëm i kapitujve kushtuar veprës letrare dhe filozofike të Lasgushit, kapitujt: I, II, III, IV, V, VIII, IX mund të themi se autori Prifti është ndalur për të bërë një analizë dhe vlerësim sa më kompleks. Por ne jemi të mendimit se nuk është i plotë për këto arsye: 1-Sistemi poetik nuk mund të kuptohet vetëm nga tematika, harmonia e saj. 2- Pjesë e këtij sistemi është edhe sistemi metrik i vargut apo strofës. 3- Sistemi poetik (figurativ). 4- Mbështetja apo reminishencat të vetëdijshme ose të natyrshme nga poezia popullore apo e kultivuar. 5- Fjalori poetik (gjuha). Të gjitha këto përbëjnë tërsinë e mjeteve letrare, që e dallojnë një krijues nga tjetri dhe quhet stil.

Gjithashtu do të shtonim se studiuesi jo në të gjitha rastet sjell të plotë poezinë, të cilën e bën objekt të analizës dhe burim vlerësimi. Mendimet e veta autori i ilustron me një varg, me një, dy e më shumë strofa, kur metodikisht, në mënyrë të veçantë, në analizë, në fillim përcaktohet figura bazë mbi të cilën e ngre poezinë autori (metaforat, personifikimet, prozopopetë, inversionet e sa e sa të tjera), duke mos harruar se figurat janë trope, figura të fjalorit poetik, figura të sintaksës poetike) dhe nuk është e lehtë për t'i përcaktuar saktësisht ato. Një varg i një strofe, apo një strofë e një poezie nuk mund të përcaktojë të tërën, pasi varen nga metrika e vargut apo e strofës. Nuk ndodh si me anatominë krahasuese, ku nga një kockë mund të përcaktohet i gjithë sistemi dhe klasa, kujt i përket.

Punimi ynë ka për qëllim të vlerësojë, të debatojë me qëndrimet, vlerësimet dhe përfundimet që dalin, sipas nesh, në botimin në fjalë "Ringjallet Rilindja e Lasgushit-po Unë?". Një pjesë syresh nuk janë

të reja janë të përsëritura në forma të ndryshme edhe në botime të mëparshme, të cilat janë bërë objekt i shkrimeve tona për librat e këtij autori: "Gjokë Risto Kondakçi" f. 300-302 dhe "Jeta dhe shoqëria e sotme në një vështrim filozofik", f. 290-300 (pjesë të këtij botimi). Ne do të ndalemi në strukturën e librit si dhe një sërë problemesh, që dalin gjatë studimit të kujdesshëm të tij.

Në vështrim të parë duket se autori e nis punimin e vet me një kronologji të autorëve, studiuesve, kritikëve të veprës së Lasgushit, duke filluar nga Gajtano Petrotta, të cilit i referohet edhe Kuteli, duke vazhduar me E. Çabejin në vitin 1929, i cili pohonte se me Lasgush Poradecin nis poezia moderne shqiptare..." f.11, ndërsa N. Bulka më 1932 pohon se "i lutet një perëndie, që nuk e di ku e ka banesën". S. Luarasi më 1936 do të shkruaj se: "... do t'ia jepnim palmën poetike poetit tonë më të ri, që quhet Lasgush Poradeci..Vargjet e tij të përsosura nuk pranojnë kurrëfarë vërejtjesh për sa i përket formës". Rexhep Qosja do ta vlerësojë: "...original në çdo pikëpamje" f.20.

Studiuesi S. Hamiti shkruan për "krijimin e një sistemi poetik vetanak", f. 20 dhe kështu mund të vazhdojmë me M.Xhaxhiun, N. Jorgaqin, Dh. Qirjazin, F. Idrizin, F. Arapin, R. Brahimi, O.Grillo, deri tek i madhi i letrave shqipe Ismail Kadare. Ajo që duhet veçuar në këtë retrospektivë është fakti se ky studiues edhe në këtë studim i grupon autorët sipas "leverdisë" me një farë pragmatizmi d.m.th.: vlerëson vetëm ata autorë punimesh që idetë, vlerësimet dhe qëndrimet e tyre përputhen me të tija, ose ato i shërbejnë si pika referimi për të ndërmarrë studime të tilla, gjë që nuk na duket e drejtë dhe aspak objektive.

Asnjëherë nuk mund të

Vazhdon në faqen 13

Vijon nga faqja 13

## Optika e vlerave dhe vlerat e një studiuesi

mendojmë se arsyetimet dhe përfundimet tona janë të drejta, që s'mund të diskutohen apo janë deduksione shkencore dhe të tjerët janë in extremis. Të nisur nga teza se praktika është kriteri i së vërtetës, do të thoshim se jo të gjithë studiuesit kanë arritur në një përfundim, pasi, sipas këndvështrimit tonë edhe këndvështrimet e tyre janë të ndryshme. Janë të pakët ata, që e kanë studiuar Lasgushin në kompleksitetin e vet.

Studiuesi Petro Prifti edhe kësaj radhe do t'i imponohet lexuesit për të gjykuar si ai dhe se ato, sipas tij, duhen marrë si postulate. Ata që gjykojnë ndryshe kanë përfundime të gabuara. Po kush na siguron ne se mund të jetë e kundërta?

Në tërësinë e vet ky botim ka dy synime: tendenca për të evidentuar, saktësuar, deklaruar, argumentuar vlerat letrare, filozofike, ideologjike, por edhe teologjike të poetit të Madh Lasgush, që "t'ia japim Shqipërisë, pastaj dhe Botës". Synimi i dytë i këtij studimi voluminoz, që ne do ta quanim një paralelizëm të panevojshëm, është tendenca e deklaruar dhe e argumentuar, sipas këtij studiuesi për të prezantuar veten, potencialin shkencor të padiskutueshëm, për "Uni"-n e tij.

Sipas analizës sonë, jo më kot, ky autor përdor në të dy vëllimet pjesën e dytë të titujve të tyre...Unë dhe Ti dhe ...Po Unë? si formë retorike. Shkojmë më tutje: Edhe kërkon të vlerësohen librat e tij, por

rekomandon se kush mund t'i vlerësojë ato, duke lënë të kuptohet, se kush do të tentojë, duhet të mendohet mirë. Ja, si gjykon: "Sidoqoftë mendime më të shumta, më të pranueshme, të pakundërshtueshme, jepen nga njerëzit me nivel të lartë, arsimor e kulturor, nga shkencëtarët, nga profesor-doktorët, që i kanë fituar titujt me djersë, nga njerëzit me përvojë të pasur jetësore, nga njerëzit e pararojës së artit, nga njerëz studiues apo autodidaktë të vërtetë, nga mençuria popullore..."

"Prolog", ("Mendime për mendimet-Dashuria Unë dhe Ti") f. 9 "...nuk duhet të guxojë të zhytet për të polemizuar ai, që nuk di të notojë në filozofi." f.335. Këto mendime ne do t'i etiketonim një

farë mimetizmi, një translato biologjie në letërsi. Natyrshëm shtrojmë pyetjen: Të kujt niveli, kujt grupimi i përkasin ata që kanë dhënë konsiderata, janë shprehur me superlativa, me paralelizma, epitete e metafora të pabazuara në analiza konkrete për botimet e autorit P.Prifti.


Ndonjë nga ato është vënë në parathënie. Këtu kemi parasysh, tashmë jo veprën letrare të Lasgushit, por studimet e këtij autori dhe vlerësimet për to. Është interesant qëndrimi i këtij studiuesi ndaj atyre që kanë tentuar ta shohin veprën e Lasgushit dhe botimet e tij në këndvështrime dhe kohë të ndryshme.

vijon në numërin e ardhshëm

"Kam parë kaq shumë tmerre në Kosovë, sa nuk dua të kem më sy"

## E kobshme, e paparë në mes të Europës...

-Rreth librit "Histori të tmerit 1998-1999" të Sanije Gashit-



"Kam parë kaq shumë tmerre në Kosovë, sa nuk dua të kem më sy"

(Meditim i heshtur ndërsa lexon "Histori të tmerit -1999". Dosje krimesh të luftës, rrëfime të grave kosovare sjellë në një libër të vetëm nga S. Gashi).

"Kam parë kaq shumë tmerre sa nuk dua të kem më sy", thotë një nënë shqiptare kur takon zonjën Clinton në kampet e Bllacës pranë Tetovës në Maqedoni, aty ku ishin strehuar si bagëti pa shpresë, mijëra kosovarë e kosovare, madje edhe shumë fëmijë të traumatizuar, njëlloj

sikur të rriturit e mbetur gjallë.

Është ky një pasazh që vjen si dëshmi kujtese në librin dokumentar të gazetares Sanije Gashi "Histori të tmerit -1999". Dosje krimesh të luftës, rrëfime të grave kosovare.

"Ndjek rrëfimet e tyre faqe pas faqeje. E ndërpres leximin. Marr frymë përsëri, për të vazhduar. Nuk është e lehtë të vazhdosh një libër të tillë, thotë diku në një shkrim të saj enkas për këtë libër, Elena Kadare." Në fakt, jo se imitoj në mendime zonjën Kadare, por e vërteta është s'e këtë përjetim pata edhe unë kur lexoja këto tmerre serbe, që s'ka ujë deti e oqeani bashkë të lajë gjakun e tyre. Këtë ndjesi, të ndërprerjes së leximit, qoftë edhe pas një faqeje të vetme e kam provuar edhe me romanin e Elvira Dones "Yjet nuk vishen kështu", por dua të shtoj se këtë ripërjetim në librin e koleges Gashi, e kam bërë gjithashtu edhe vetëm pas dritëparjes të fotografive rrëqethëse të këtij botimi, që përbën histori të dëshmuar për mbarë botën. Ndërkaq, përpjekja e librit synon në gjetjen dhe shpjegimin e disa mekanizmave të të ashtuquajturit "sistem i analogjive",

i cili shtrihet në rrafshin viziv e konceptual të strukturave, që nga imazhet e deri te tërësia e tmerreve. Them analogji se ato pak a shumë janë të njëjlojta vetëm se kanë emra dhe moshë të ndryshme...

Kemi të bëjmë me 33 tregime tmerri, pra 33 histori, që rrëfohen e qëndrojnë të mevetësishme apo kemi 33 kapituj të lidhur ngushtë me qëndresën, që i japin kësaj veprë strukturën e një seriali dokumentar pavdekësie. Mendoj se mëvetësia e këtyre 33 "njësive" është relative, si mëvetësia e pjesës në raport me të tërën. Ma përforcon këtë mendim, fakti që simbolet, por edhe strukturat formale të njësive të veçanta, rimerren në dimensionet e këndvështrime të reja në njësitet pasardhëse, duke krijuar kështu një mozaik përherë e më të plotë të luftës kosovare të mijëvjeçarit që shkoi. Në fokus të këtij shkrimi do të ve zbërthimin dhe bashkëlidhjen strukturore të rrëfimeve, për të përfutur, së fundmi, një skemë të plotë të arkitekturës së veprës që mban emrin dëshmi tmerri. Foto njerëzish të zhdukur apo që thjesht etiketohen si të humburit e këtij

genocidi të çmendur, kam parë edhe në kangjellat e qeverisë së Kosovës. Ata ishin shumë... dhe kërkonin shpagim. Ndërkaq ato foto të pafundme më bashkohën me 30 fotot e vendosura në fund të këtij botimi të Gashit.

Po e mbyll këtë meditim mbijetese dhe krenarie njëherazi, sërish me fjalët e zonjës Kadare.

"Dua ta them: Të lexosh një libër të tillë, në mbarim të tij nuk je më ai që kishe qenë disa orë më parë. Shumë herë m'u desh të ndalem, të vështroj jashtë nga dritarja, për t'u bindur se bota reale ekziston vërtet, se njerëzit vazhdojnë të ecin normalisht, se ata bisedojnë si përherë, se ata nuk e kanë humbur buzëqeshjen, se bëjnë ende plane për jetën... Megjithatë, pas këtij libri, kurrësesi s'mund të jesh më ai që ke qenë. Sepse në botë, jo kushedi se sa larg prej këtej, po këtu, mu në zemër të Evropës, ka ndodhur diçka e kobshme, e paparë, hollësitë e së cilës njerëzit duhet t'i mësojnë me urgjencë, për të ditur si ta mbrojnë atë bisedë, ato plane, atë ecje të përditshme, gjithçka që mban në këmbë atë që quhet jetë njerëzore."

Ilir Shyta

# Gusha endemike

*Dr. Andrea Kocaqi*

Gusha endemike ose struma është një sëmundje e gjëndrës tiroide e cila ndodhet në fund të gushës nga ku e ka marrë edhe emërtimin. Shenja më karakteristike e kësaj sëmundjeje është zmadhimi i kësaj gjendre që shoqërohet me disa pasoja jo të këndshme të cilat do t'i shohim pak më poshtë. Nga ana mjekësore zmadhimin e gushës e ndajmë në tri shkallë. Shkalla e parë ku zmadhimi i gjëndrës vihet re vetëm nëse i themi pacientit që të tendosë qafën prapa e më pas të kapërdihet. Ka raste kur është i nevojshëm edhe palpimi i gjëndrës në pozicion të qetë, natyrisht nga një dorë e stërvitur. Shkalla e dytë konsiderohet kur vihet re një zmadhim i lehtë i zonës së gushës pa qenë nevoja e tendosjes së qafës. Dhe shkalla e tretë kur vihet re një zmadhim shumë i madh i gjëndrës që shkon nga madhësia e një mandarine e deri në madhësinë e një koke të një femijë të porsalindur. Ka edhe një variant tjetër që quhet gusha ose struma nodulare ose me gunga.

Deri disa dekada më përpara pretendohet se kjo sëmundje ishte e përhapur vetëm në zonat e thella malore, larg bregdetit. Por depistimet e vazhdueshme dhe të herëpashershme vërtetuan se gusha endemike është e përhapur pothuajse në të gjithë territorin. Kështu në të gjithë rruzullin 1/3 e popullsisë është e prekur nga kjo sëmundje. Pikërisht për shkak të kësaj shtrirjeje është mbiquajtur dhe endemike. Edhe në vendin tonë shtrirja e kësaj sëmundjeje është në 80% të territorit dhe numri i popullsisë shkon në pothuajse 50% të saj. Mekanizmi i shfaqjes së kësaj sëmundjeje është fare i thjeshtë. Nga mungesa e prezencës së jodit në organizëm, struma, (gjëndra e tiroides), në mënyrë kompesatore zmadhon volumin e saj për të kapur edhe atë pak jod që mund të ekzistojë në qarkullim, të cilin e ka aq të nevojshëm për të prodhuar hormonet e saj. Mungesa e jodit në organizmin tonë mund të shkaktohet; a). Nga faktorë të brendshëm, si mos përthithja e tij nga aparati tretës, apo ndonjë

sëmundje gjenetike (e trashëgueshme). b). Nga faktorë të jashtëm, si mungesa e jodit në ushqime dhe çfarë është më e rëndësishmja dhe më e videntueshmja mungesa e tij në ujin e pijshëm.

Por për pos anës estetike çfarë tjetër shkakton dhe përse ka rëndësi të parandalohet kjo sëmundje? Pak më lart shpjegova se mungesa e jodit në organizmin tonë sjell si pasojë uljen e prodhimit të hormoneve nga ana e gjëndrës së tiroides të cilët nga ana e tyre shkaktojnë disa pasoja negative, që për t'i kuptuar më qartë do të dëshiroja t'i ndaja në disa drejtime.

1- Në njerëzit e rritur; shkakton ulje të metabolizmit bazal, ulje të ritmit të zemrës, përgjumësi, dobësi, ulje të aftësisë për punë, ulje të aftësisë për t'u kujdesur për veten dhe për familjarët e tyre, (pra ulje të aftësive psiko-sociale), shtim të kolesterolit në gjak me gjithë pasojat e saj që tashmë dihen.

2- Në gratë shtatzëna; shkakton dështime, lindje para kohe, lindje me peshë të ulët e me pak shanse për të jetuar, lindje të fëmijëve me deformime të ndryshme e deri në lindje të fëmijëve të vdekur (in utero).

3- Në fëmijët; shkakton dëmtime të përhershme të trurit, vonesë të zhvillimit të trurit, të meta apo prapambetje mendore, defekte në të folur, në të dëgjuar, mundësia për paraliza të ndryshme. Në moshën shkollore ulje të përqendrimit, vështirësi në të mësuar, ngathtësi, dobësi e mungesë të zhvillimit fizik.

4- Në shoqëri; shton njerëz me më pak produktivitet e iniciativë, ulje të zhvillimit ekonomik, shkencor e artistik, pra deri në uljen e inteligjencës së një kombi në përgjithësi. Dhe ta mendosh hollë që të gjitha këto negativizma vijnë nga një faktor fare i pa rëndësishëm në dukje e banal, pra mungesa e jodit në organizëm, ose e thënë më thjesht mungesa e 100 – 200 gama jod që



është dhe nevoja ditore për të. Pra besoj se e kuptoni se sa i rëndësishëm është parandalimi i kësaj sëmundjeje për të mos arritur deri tek mjekimi pasi për të do të jetë mjeku i familjes apo ai specialist që do të vendosë për mjekimin tuaj. Qysh në fillim dëshiroj të them se parandalimi i gushës endemike është krejtësisht i mundur dhe lehtësisht i realizueshëm. Le të fillojmë me ushqyerjen. Ndër ushqimet me përmbajtje të mjaftueshme jodi mund të përmendim; prodhimet e detit si peshku, midhjet, karkalecat e detit e tj. , frutat dhe perimet si hurma, limoni dhe agrumet e tjera n“Kam parë kaq shumë tmerre në Kosovë, sa nuk dua të kem më sy” në përgjithësi, patatja, speci, domatja etj. Frekuentimi i plazheve bregdetare të paktën për disa ditë rresht për ç’do vit, do të ishte një masë tjetër e dobishme parandaluese. Por a mjafton vetëm kaq? Natyrisht që jo. Për këtë aresye mjekë e shkencëtarë të ndryshëm prej kohësh kanë bërë përpjekje për metoda masive dhe sa më të efektshme për parandalimin e kësaj sëmundjeje. Janë bërë përpjekje për jodizimin e ujit të pijshëm, më pas të bukës masive, por pa rezultate optimale deri sa më në fund u praktikua me shumë sukses jodizimi i kripës. Kjo metodë vazhdon të aplikohet me shumë efektshmëri edhe në ditët tona pothuajse në të gjitha vendet. Kaq e suksesshme rezultoi kjo metodë sa dëshiroj t’ju shpjegoj se

kripa e jodizuar është e dobishme dhe e rekomanduar edhe për gratë shtatzëna, për nënat me fëmijë në gjë edhe për fëmijët e vegjël. Kripa e jodizuar nuk ndryshon shijen e ushqimeve, përfshi këtu edhe bukën edhe turshitë. Porosi do të desha t’ju jepja amvisave që jo vetëm të përdorin gjithmonë kripë të jodizuar, por atë ta hedhin në gjellë në fund të zjerjes pasi vlimi do ta shkatërronte jodin prezent në të, të vëreni datën e skadencës të shënuar në amballazh të jetë sa më e largët dhe e fundit në kuzhinë kripën duhet ta mbani në enë të mbyllur mirë për të shmangur lagështimin dhe avullimin që po ashtu do ta shkatëronin jodin. Porosi tjetër është që të mos përdorni në asnjë mënyrë apo formë jodin që mjekojmë plagët, sepse ai është jod metalik e nuk ka asnjë vlerë për qëllimin që po shtjellojmë. Në masat e tjera parandaluese mund të përmendim edhe dhënie e fluor natriumit grave shtatzëna 1 kokërr në ditë prej 1 mg. , por kjo është më shumë detyrë për t'u zgjidhur nga mjeku i familjes apo ai që mbulon konsultorin përkatës.

Madje edhe bagëtitë kanë nevojë për kripë të jodizuar pasi mungesa e tij, ashtu si edhe tek njerëzit shkakton dështime, prodhim të ulët të qumështit, vezëve, mishit dhe leshit. Së fundi dëshiroj ta mbyll me një shprehje të goditur mjekësore-popullore cituar për këtë problem. “Për një familje të shëndetshme dhe femijë të zgjuar, përdorni gjithmonë kripë të jodizuar”.

## Këndi i përkthyesit

## Miqve të mi më të mirë

Nga Manjola Gusho

Miqësia është si dashuria, një gjendje euforike. Nuk mund të zgjedhësh një njeri dhe t'i thuash: "Dëshiroj të jesh miku im", por zgjohesh një ditë dhe e kupton që ashtu si dhe kur je i dashuruar, ndihesh i lidhur me dikë si me disa fije të pazgjidhshme.

Miqtë më të mirë nuk janë ata, të cilët të tradhetojnë dhe të zgjënjejnë më pak, por ata të cilët megjithëse të tradhetojnë dhe të zgjënjejnë, ti nuk mundesh dot mos t'i falësh, për të cilët gjen gjithmonë vend për t'i dashuruar në zemrën tënde. Nuk je asnjëherë i sigurtë nëse mikun më të mirë do ta kesh pranë në momentet më të vështira, por je i sigurt që pasi ta kalosh vështirësinë, do të mundesh t'i tregosh se si je ndjerë dhe ai të të kuptojë. Sepse ndonjëherë në jetë me të vërtetë ke nevojë të jesh dhe vetëm. Në jetë takon shumë miq, por shumë pak ngeken në "rrethin zero" të zemrës tënde. Atje ka vend gjithmonë, por ngelen ata, të cilët ti i konsideron vëllezër, jo gjaku, por



shpirti. Në "rrethin zero" hyjnë vetëm miqtë, me të cilët ti mund të jesh vetvetja pa pasur frikë. Ata të cilëve mund t'ua thuash në fytyrë se çfarë mendon për ta. Nga të cilët nuk të vjen turp, të cilëve mund t'ua thuash secrete, pranë të cilëve mund të fletësh i qetë. Jam shumë mirënjohës ndaj atyre, të cilët gjenden në "rrethin tim zero".

Kemi kaluar së bashku provën e viteve dhe të ngjarjeve të çdo lloji. Miqtë më të mirë janë ata me të cilët ke për të bërë të njëjtën rrugë, jo sepse ashtu dëshiron, por sepse ashtu duhet. Një mik të vërtetë "nuk e bën", por "e zbulon". Çfarë bekimi!

## Sport

## Liqenorët kapin kreun e tabelës

Ekipi i Futbollit në qytetin e Pogradecit tregoi një paraqitje mjaft të mirë gjatë fazës së parë. Kështu ai bëri të mundur të zërë kreun e tabelës me 37 pikë, me 5 pikë më shumë nga ekipi i Kamzës, i cili ndodhet në vendin e dytë. Presidenti i KF të këtij qyteti, zoti Artan Shkëmbi, si dhe gjithë stafi drejtues dhe të gjithë futbollistët, kanë venë si objektiv të futen në Superlig.

Futbolli pogradecar e mbylli fazën e parë me 12 fitore, 1 barazim dhe 2 humbje. Golovarazhi: 25 gola të shënuar dhe 10 të pësuar.

Kryebankina pogradecare, zoti Ylli Çekiçi shprehet shumë optimist për ekipin dhe ka besim se me këtë ekip dhe staf edhe fazën e dytë do të kryejë, por do ta fut ekipin në kategorinë superiore. Kjo arritje nuk është vetëm pasioni dhe puna e madhe, që bën trainieri i ekipit me ndihmësat e tij, gjithë ekipi, por

faktorë ka qenë edhe infrastruktura e re dhe bashkëkohore e krijuar.

Federata Shqiptare e Futbollit i dhuroi qytetit tonë dhe sportdashësve pogradecar fushën e re të futbollit, aneksin me tapet të ri artificial dhe tapetin natyral të stadiumit.

Shumë futbollistë të kategorisë superiore tani në merkaton e dimrit, janë treguar të gatshëm të luajnë në fazën e dytë me ekipin e Pogradecit, u shpreh trainieri Ylli Çekiçi. Lojtarë, si: Raboshta, Korçari, Mema apo maqedonasi Andeskiev, Çekiçi vendosi që fazën e parë ta mbylli me lojtarët, që ka aktualisht. Por është më se normale që në një ekip të tillë të afrohen edhe sportistë të tjerë me nivele të dëshiruara për të realizuar objektivin kryesor, por edhe për të kënaqur gjithë sportdashësit e qytetit tonë.

Esat Berberi

## Letërsi

## Penny

I vogël sa një thua. Me një rrezëllim të kuqërremtë që më i dukshëm bëhet nën rrezet e diellit.

Në thyerjen e dollarëve, pas blerjeve, penny vjen i fundit, me një tingëllimë të drithshme mbi pjatëzën e vogël të metalit të arkës ku derdhen automatikisht paret e vogla. Ndodh kështu për rrjedhojë të vlerës së tij të barabartë me një të njëqindën e dollarit. Blerësit bëhen nervozë teksa fusin gishtrinjtë në pjatëz të mbledhin monedhat e kuqërremta, të vogla, të lehta duke nderë drejt tyre një shikim paksa përbuzës. Por edhe pse në thyerjen e dollarit, penny vjen i fundit, në ushtrinë e madhe plot grada e tituj të dollarit në renditje radhitet i pari.

Duan, s'duan konsumatorët e gjithë shtresave që bezdisen kur shpesh mbushin duart me penny prej aty fillon perandoria çudibërëse e parasë. Si të thuash penny është themeli. Është guri i parë, pas të cilit renditen gjithë të tjerët.

Megjithatë sikur të mos ekzistonte realisht kjo pennin shpesh e sheh në anë të trotuarëve, aty ku përplasen e tkurren mbetjet e plehrave, të braktisur e të harruar nën stolat në parqe, nën krevate në dhomat e hoteleve të porsazbrazura nga klientët shpesh të rënuar ekonomikisht, pa shtëpi, pa punë, drogaxhinj, mafiozë, vrasës, të rinj që provojnë mrekullinë e seksit për

herë të parë, pleq të braktisur nga fëmijët e të afërmit etj.

Para se të ikin ata shkundin kuletat, xhepat e pantallonave e të xhaketave nga penny bezdisës.

Dhe ndodh, i braktisur, i harruar, nën ndikimin e shiut, borës, erës penny të deformohet, tkurret, të humbasë shkëlqimin farfuritës, të kuqërremtë duke shkuar drejt nxirjes. Oh të vjen keq ta shohësh të tillë, si një mbetje metali e varrezave të makinave!

Por... ka edhe raste "rehabilitimi" për të. Ndodh që pas larjes nga shiu, dielli i porsa dalë shkëmben mesazhe me pennyn e mjerë duke e bërë pak më të dukshëm e më rrezatues. Dikush,

-skicë-






një amvisë e mirë, një punëtor i rregullt fabrike që nxiton të respektojë orarin e punës, një nëpunës banke dhe qeverie dhe milionerë që shëtisin e që dinë ç'është paraja e ç'vlerë reale ka çdo pjesëzë e saj, ulen dhe e marrin në dorë pennyn që mallkimin më të madh e ka nga xhëpshpuarit, mjeranë të vërtetë.

Kostaq Duka



Shtëpia botuese “DIJA-Pogradeci” vlerësoi tre vëllimet poetike më të mirat për vitin 2010:

- Besnik Bedollari,**  
“Ujvara e fyellit”
- Antologji poetike,**  
“Egnatia e fjalës...”
- Thodhori Miho,**  
“Gjergj Basta dhe kapedanët e Senicës”.



## Njoftim

Në kuadër të përpjekjeve për eliminimin e dhunës në familje, Shoqata “Unë, Gruaja” organizon projektin me titull “Dhuna në familje ndalon këtu”.

Me këtë projekt “Unë, Gruaja” synon të forcojë përpjekjet e individëve dhe komunitetit për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje. Kjo do të realizohet, duke u ofruar, individëve që kanë marrë diploma universitare në fushat e psikologjisë dhe sociologjisë, një edukim më të specializuar për dhunën kundër gruas. Synimi ynë është të informojmë komunitetin e Korçës dhe Pogradecit për dhunën në familje. Nëpërmjet kësaj iniciative, ne do të krijojmë dhe realizojmë një model të shërbimit vullnetar, i cili do të ofrojë shërbime pa pagesë për gratë e abuzuara. Këta persona do të trajnohen si të këshillojnë dhe të ndihmojnë viktimat e dhunës në familje. Ne duam t’u japim një mundësi studentëve të diplomuar të tregojnë aftësitë e tyre dhe të praktikojnë njohuritë që kanë marrë gjatë viteve të studimit. Gjithashtu do të krijojmë një bazë të dhënash të individëve të cilët duan të jenë vullnetarë dhe t’i dërgojmë ata në komunitet, të informojnë publikun për dhunën në familje si dhe të ofrojnë ndihmë për gra e vajza të



abuzuara. UG do të shërbejë si një qendër që shpërndan dhe koordinon vullnetarë tek shoqatat që kanë të njëjtin fokus, dhunën në familje. Kështu, ato shoqata që janë të interesuara për këtë shërbim, mund të kontaktojnë të UG (në kontaktet e poshtëshënuara) dhe të kërkojnë vullnetarë. Nëpërmjet këtij projekti ne dëshirojmë të sjellim një frymë të re në qytet, atë të vullnetarizmit.

Personat e interesuar të paraqesin kërkesën dhe CV pranë shoqatës “Unë, Gruaja” në adresën:

Rr. “Reshit Çollaku”

Pranë Komisarariatit të Policisë

Pogradec

Tel: 083 222140 / 08322 5104

e-mail: [une\\_gruaja@yahoo.com](mailto:une_gruaja@yahoo.com)

Është koha për KASH

**SOCIETE GENERALE ALBANIA**

Së bashku për të ardhmen



[www.societegenerale.al](http://www.societegenerale.al)

Kredi Ardhme Shtëpi  
në Euro

**6.9%\***

\*Paa vitit të parë norma e interesit është Libor Euro 12M + 4.5% (minimumi 6.9%) në vit

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO  
Në kompjuter: Edlir PODA  
Lexoni gazetën në: [www.poradeci.com](http://www.poradeci.com)  
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "DIJA - Poradeci" -Pogradec  
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec  
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753  
e-mail: [afrovitig@yahoo.com](mailto:afrovitig@yahoo.com)